


WFD

HARTËZIMI I PROBLEMATIKËS MJEDISORE PËRGJATË BREGDETIT NË SHQIPËRI.

Rast Studimor: Qarku Vlorë, Durrës dhe Lezhë.



Hartëzimi i problematikës mjedisore përgjatë bregdetit në Shqipëri.

Rast Studimor: Qarku Vlorë, Durrës dhe Lezhë.

Gusht 2021



Ekspertët
M.Sc. Olsi Nika
M.Sc. Alketa Skëndaj
@EcoAlbania, Tiranë 2021

Foto kopertina:
Alessio Corradini 2021

Përgatitja grafike dhe faqosje:
Ermal Shenaj



WFD



UK Government

Mohim: Autorët e prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci



Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
LISTA E TABELAVE	8
LISTA E FIGURAVE DHE GRAFIKËVE	8
LISTA E SHKURTIMEVE	9
1. HYRJE	11
1.1 Struktura e raportit	11
1.2 Qëllimi i studimit	11
2. METODOLOGJIA	13
3. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE	17
3.1 Konteksti i përgjithshëm për zonën bregdetare	17
3.2 Kategoritë mjedisore dhe problemet	19
3.3 Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur	21
3.4 Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike	23
3.5 Ndotja detare dhe portuale	25
3.6 Shkatërrimi i biodiversitetit	28
3.7 Sfidat e zhvillimit bregdetar	31
4. ANALIZIMI DHE PRIORITIZIMI I ÇËSHTJEVE MJEDISORE BREGDETARE	35
4.1 Qarku Vlorë	35
4.1.1 Problematikat kryesore mjedisore në Qarkun e Vlorës	36
4.1.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Vlorës	36
4.2 Qarku Durrës	40
4.2.1 Problematikat kryesore mjedisore në Qarkun e Durrësit	42
4.2.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Durrësit	42
4.3 Qarku Lezhë	47
4.3.1 Problematika kryesore mjedisore në Qarkun e Lezhës	48
4.3.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Lezhës	49
5. PËRFUNDIME	55
LITERATURA	58
SHTOJCA A. PYETËSORI PËR VALIDIMIN E PROBLEMATIKAVE MJEDISORE	59

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i brezit bregdetar është i një rëndësie strategjike dhe kombëtare për vendin tonë. I shtrirë në një gjatësi prej 316 km vijë bregdetare nga Shkodra në Konispol, ai është aseti më i vlefshëm i Shqipërisë në kontekstin ekonomik, gjeopolitik dhe turistik, jo vetëm në pellgun e Adriatikut por dhe më gjerë në pellgun e Mesdheut.

Hapësira e bregdetit është e shpërndarë administrativisht në 12 njësi vendore, pas Reformës Administrative Territoriale në 2014, ku afërisht jetojnë 427,634 banorë ose 13.2% e popullsisë së vendit.¹

Ky studim mori në shqyrtim përzgjedhjen e tre qarqeve Lezhë, Durrës dhe Vlorë, identifikimin e problematikave mjedisore të këtyre qarqeve e fokusuar në zonën bregdetare dhe më pas analizën e problematikës mjedisore duke finalizuar në një raport të Portofolit të Problematikave Mjedisore të Bregdetit.

Përzgjedhja e tre qarqeve u krye duke u bazuar në disa faktorë kryesorë ku mbizotërojnë faktori gjeografik, frekuenca e turizmit, niveli i ndotjes dhe sinjalizimi i problematikës lidhur në këto qarqe. Në aspektin gjeografik, 3 qarqet e përzgjedhur kanë një shtrirje përfaqësuese Shqipëri e veriut, e mesme dhe jug. Ndërsa në aspektin turistik dhe potencialit të tyre, qarku Vlorë është një ndër destinacionet kryesore me shtrirje të gjatë që mbulon gjithë brezin bregdetar jonian; qarku i Durrësit ka kapacitete më të mëdha të turizmit sidomos pushuesve nga Kosova dhe qarku i Lezhës është një destinacion me potencial në rritje ku spikatin plazhet e Shëngjinit, Rana e Hedhun dhe Tales.

Si fillim, studimi hartëzoi problematikën e shumtë mjedisore përmes hulumtimit ku u përcaktuan 5 kategori të problematikave mjedisore kryesore dhe 30 problematika mjedisore të shpërndara sipas 3 qarqeve kryesore Lezhë, Durrës dhe Vlorë.

¹ Instat, Census 2011. www.instat.gov.al

Tabela 1: Hartëzimi i problematikave mjedisore përgjatë bregdetit - hulumtimi nga zyra.

NR.	KATEGORITË	PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA
1	Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e landfillleve sanitare përgjatë vijës bregdetare; - Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur urban; - Ekzistenca e vend depozitimeve ilegale dhe jo sanitare përgjatë brigjeve të lumenjve;
2	Erozioni detar dhe tokësor	<ul style="list-style-type: none"> - Erozioni detar në deltën e Kune-Vain-it; - Kripëzimi i tokave bujqësore bregdetare si pasojë e erozionit detar në deltat e lumenjve; - Erozioni në gjiret e jugut; - Krijimi i pontileve² të jashtëligjshëm në zonën e Durrësit dhe Vlorës;
3	Ndotja detare dhe portuale	<ul style="list-style-type: none"> - Derdhja e mbetjeve hidrokarbure në lumenjtë Vjosë, Seman dhe Erzen; - Shkarkimi i ujërave të ballastës së anijeve në 4 portet shqiptare dhe 3 portet private;
4	Shkatërrimi i biodiversitetit të rivierës	<ul style="list-style-type: none"> - Shtimi i specieve evazive (p.sh. gaforja blu në Lagunën e Kune-Vain-it); - Shtimi i specieve invazive në Lagunën e Nartës; - Peshkimi i paligjshëm përgjatë gjithë pjesës bregdetare; - Përdorimi i mjeteve shpërthyes (dinamit, TNT) në Gjirin e Karaburunit dhe Sazanit për dater-in; - Rritja e eutrofikimit në Gjirin e brendshëm të Gadishullit të Karaburunit si pasojë e akua-kulturës të paplanifikuar dhe mungesës së kontrollit;
5	Konfliktet e zhvillimit bregdetar	<ul style="list-style-type: none"> - Urbanizimi i lartë bregdetar në Bashkinë Durrës, Shëngjin dhe Himarë; - Shndërrimi i sistemeve natyrore dhe bujqësore në sisteme urbane në shkelle me planë urbane vendore të përgjithshme; - Ndryshimi dhe ngushtimi i zonave të mbrojtura mjedisore të shtrira përgjatë vijës së bregdetit;

Më pas këto problematika janë vlerësuar në workshopet rajonale ku janë ftuar aktorët përkatës të Qarqeve Vlorë, Durrës e Lezhë të listojnë problematikat mjedisore evidente në qarqet respektive.

Me pjesëmarrjen e 40 aktorëve (17 femra dhe 23 meshkuj) si përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore, përfaqësues të OSHC-ve, botës akademike dhe sektorit privat u vlerësuan dhe renditën problematikat kryesore sipas prioritetit dhe rëndësisë që paraqesin në zonat e tyre.

Problematikat e identifikuar do të shërbejnë si një portofol i rëndësishëm diskutimi dhe konsultimi mes përfaqësuesve të legjislativit, ekzekutivit dhe komunitetit në qarkun e Vlorës dhe Durrës-it. Takimet do të realizohen gjatë muajit tetor 2021 dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm për prezantimin e problematikes mjedisore.

² Një platformë prej guri ose druri që shtrihet nga bregu në det ose liqen dhe përdoret si vend ankorimi për varka ose si vend argëtimi

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Hartëzimi i problematikave mjedisore përgjatë bregdetit - hulumtimi nga zyra	4
Tabela 2: Hartëzimi i kategorive mjedisore bregdetare	11
Tabela 3: Forma e menaxhimit të mbetjeve urbane sipas njësive vendore	19
Tabela 4: Rastet e ndotjes hidrokarbure të raportuar nga media	23
Tabela 5: Rastet e ndotjes detare dhe peshkimit të paligjshëm të raportuara nga QNOD	23
Tabela 6: Zonat e Mbrojtura Mjedisore përgjatë bregdetit shqiptar	29
Tabela 7: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuara në zonën bregdetare të Qarkut të Vlorës	32
Tabela 8: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuara në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit	39
Tabela 9: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuara në zonën bregdetare të Qarkut të Lezhës	45

LISTA E FIGURAVE DHE GRAFIKËVE

Figura 1: Kuadri metodologjik i raportit.	10
Figura 2: Kufiri tokësor dhe detar i Shqipërisë. Burimi: AKPT, 2016	14
Figura 3: Ndotja në deltën e Lumit Ishëm, Qarku Durrës	16
Figura 4: Harta e Venddepozitimeve në Shqipëri, 2018	17
Figura 5: Shkarkimet e ujërave të përdorur në bregdetin e Durrësit © "e përditshma", 2018	18
Figura 6: Avancimi i detit drejt plazhit si pasojë e erozionit detar në bregdetin e Semanit © David Galjaard "Gazeta liria", 2017	20
Figura 7: Avancimi i detit drejt plazhit si pasojë e erozionit detar në bregdetin e Semanit © Megi Zonja "ATSH", 2018	22
Figura 8: Flota detare në Shqipëri sipas porteve.	24
Figura 9: Paraqitja në hartë e porteve detare	25
Figura 10: Struktura e zënieve nga peshkimi sipas %	25
Figura 11: Ndryshimet territoriale sipas planeve zhvillimore vendore, 2017	28
Figura 12: Ndryshimet e propozuara për ZM nga AKZM, 2021.	30
Figura 13: Ndryshimet relative të propozuara për ZM nga AKZM, 2021.	30
Figura 14: Harta e rivierës në qarkun Vlorë. Burimi: Bashkia Vlorë & DeaStudio, 2016.	32
Figura 15: Pritoritarizimi i çështjeve mjedisore në Qarkun e Vlorës	34
Figura 16: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen nga mbetjet urbane në zonat bregdetare të Qarkut Vlorë	35
Figura 17: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Vlorës	36
Figura 18: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Vlorës	36
Figura 19: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me shkatërrimin e biodiversitetit në Qarkun e Vlorës	37
Figura 20: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me konfliktet e zhvillimit të bregdetit në Qarkun e Vlorës	38
Figura 21: Harta e Qarkut Durrës. Burimi: Shtetiweb	38
Figura 22: Pritoritarizimi i çështjeve mjedisore në Qarkun e Durrësit	40
Figura 23: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen nga mbetjet urbane në zonat bregdetare të Qarkut Durrës	41
Figura 24: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Durrësit	41
Figura 25: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Durrësit	42
Figura 26: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me shkatërrimin e biodiversitetit në Qarkun e Durrësit	43
Figura 27: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me konfliktet e zhvillimit të bregdetit në Qarkun e Durrësit	43
Figura 28: Harta e qarkut Lezhë. Burimi: ShtetiWeb.	44
Figura 29: Pritoritarizimi i çështjeve mjedisore në Qarkun e Lezhës	46
Figura 30: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen nga mbetjet urbane në zonat bregdetare të Qarkut Lezhë	47
Figura 31: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Lezhës	47
Figura 32: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Lezhës	48
Figura 33: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me shkatërrimin e biodiversitetit në Qarkun e Lezhës	49
Figura 34: Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me konfliktet e zhvillimit të bregdetit në Qarkun e Lezhës	50

LISTA E SHKURTIMEVE

AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AdZM	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
DLDM	Programi për Qeverisjen Vendore
IKMT	Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Instituti për Kredi për Ndërtim)
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural
QNOD	Qendra Ndër-institucionale Operacionale Detare
PBB	Produkti i Përgjithshëm Bruto
UNCLOS	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit
ZM	Zonë e Mbrojtur
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci

1. HYRJE

1.1 Struktura e raportit

Kapitulli i parë paraqet objektivat e studimit, karakteristikat e përgjithshme të vijës bregdetare të Shqipërisë dhe iniciativat e mëparshme që ndërlidhen me studimin e bregdetit. Objektivi kryesor i këtij raporti është sigurimi i dëshmive dhe të dhënave mbi çështjet mjedisore për të advokuar në adresimin e problemeve mjedisore dhe duke ndikuar te politikëbërësit.

Kapitulli 2 paraqet metodologjinë e përdorur për të identifikuar pikat dhe burimet ndotëse përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë, specifikisht në qarkun Vlorë, Durrës dhe Lezhë duke i dhënë përparësi pikave të nxehta të ndotjes.

Kapitulli 3 paraqet identifikimin e problematikës kryesore të ndotjes duke iu referuar punës kërkimore dhe ndërlidhjes me studime dhe qasje të mëparshme nga institucionet shtetërore, donatorë të mundshëm, raportimi nga media mjedisore apo organizatat e shoqërisë civile.

Kapitulli 4 paraqet burimet kryesore të ndotjes në secilin qark, vendet prioritare të pikave të nxehta sipas prioritizimit nga aktorët vendore.

Përfundimet dhe rekomandimet janë paraqitur në Kapitullin 5. Ndërsa informacioni i detajuar paraqitet në **Aneksin A**.

1.2 Qëllimi i studimit

Zhvillimi i rajoneve bregdetare në Shqipëri është bërë një përparësi për planin kombëtar të zhvillimit që shpesh drejtohet nga interesi dhe axhenda e sektorit privat. Shpesh, plane të tilla zhvillimi nuk këshillohen me aktorë të ndryshëm lokalë dhe nuk marrin parasysh shqetësimet e ndikimeve mjedisore lokale ose kombëtare. Prandaj, ekziston një nevojë e shtuar për një angazhim më proaktiv të OShC-ve dhe aktorëve të tjerë që do të konsultohen dhe të ndikojnë tek vendimmarrësit duke marrë parasysh shqetësimet e ndryshme mjedisore të komuniteteve të tyre.

Ky studim është ndërmarrë nga Westminster Foundation for Democracy (WFD) në partneritet me Qendrën EcoAlbania. Në kuadrin e këtij programi, WFD Albania po zbaton iniciativën, "Pjesëmarrja e OShC-ve në vendimmarrje". Bazuar në analizat e WFD në Shqipëri, shoqëria civile është përfshirë kryesisht në fazën e zbatimit të politikave, por rrallë merr pjesë në fazën e përcaktimit të agjendës ose politikëbërjes. Situata është më e keqe në ekzekutiv (ministrinë dhe linjës dhe Këshillin e Ministrave), pasi shpesh, ata paraqesin legjislacion dhe rregullore pa u konsultuar me palët e interesit. OShC-të mjedisore kanë më pak akses tek vendimmarrësit në krahasim me OshC-të e tjera, pasi mjedisi nuk konsiderohet si një përparësi kryesore për zhvillimin e vendit.

Sidoqoftë, ekziston një grup solid i OShC-ve të specializuara në çështjet mjedisore të cilat kanë kapacitetet dhe përvojën e duhur por përballen me pengesa të ndryshme për sa i përket ndikimit në politikëbërje në nivelet lokale dhe qendrore.


Si rezultat, ky studim ka si qëllim të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Të identifikojë dhe hartëzojë problematikat mjedisore përgjatë rivierës detare në 3 rajonet kryesore në vend;
- Të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet vendimmarrësve dhe shoqërisë civile;
- Të rrisë ndërveprimin e OShC-ve me vendimmarrësit në çështjet mjedisore.

2. METODOLOGJIA

Kuadri metodologjik

Metodologjia që u ndoq për identifikimin e problematikës mjedisore në zonat bregdetare është paraqitur në figurën 1 më poshtë, ku janë përcaktuar dhe fazat kryesore për përgatitjen e këtij dokumenti.



Hapi fillestar ishte një studim i plotë i të gjitha burimeve të disponueshme të të dhënave për studimin tonë. Për këtë qëllim janë mbledhur artikuj, raporte, plane menaxhimi dhe burime të tjera, nga agjencitë dhe individët që kanë informacion, interes ose përfshirje në zonë. Përmes interpretimit dhe vlerësimit të të dhënave nga ekipi i ekspertëve u realizua identifikimi i problematikës kryesore mjedisore në tre qarqet përkatëse.

Faza e dytë e metodologjisë përfshin organizimin dhe sintezën e informacionit të krijuar në një inventar ose kornizë të zbatueshme. Ky është një proces klasifikimi ku të dhënat u grupuan dhe kategorizuan në pesë fusha më të mëdha. *Shiko Tabela 2 më poshtë.*

Faza e tretë është hartëzimi i problemeve mjedisore, i cili është jo vetëm i dobishëm si një mjet analize nga profesionistët, por është gjithashtu një mjet për ilustrimin grafik efektiv të fakteve dhe gjykimeve. Para së gjithash është një mjet i nevojshëm për të arritur pjesëmarrjen e informuar të publikut, veçanërisht kur kombinohet me përdorimin tërheqës dhe krijues të fotografive dhe materialeve të tjera mbështetëse vizuale.

Faza e katërt e metodologjisë konsistoi në një sistem vlerësimi dhe prioritizimin i gjithë problematikave të grumbulluara përmes pikëzimit. Ekipi i projektit ndoqi një qasje me shumë hapa për të vlerësuar përgjigjet për çdo pikë të nxehtë dhe kriter. Së pari, shkalla e vlerësimit u shndërrua në numra për të lejuar kuantifikim të rezultateve, duke filluar nga 0 ("shumë e ulët") në 5 ("shumë e lartë"). Së dyti, ekipi i projektit llogariti mesataren për secilën pikë të nxehtë dhe kriter për grupin përkatës të palëve të interesuara për të siguruar përfaqësim të barabartë për secilin grup, pavarësisht numrit të të konsultuarve për grup. Së treti, vlerat

për grup të aktorëve u mesatarizua për të marrë vlerat përfundimtare për të tre kriteret për pikat e nxehta. Së katërti, ekipi i projektit renditi pikat e nxehta (sipas numrit të përmendjeve) që treguan palët e interesuara do të përfitonte më së shumti nga mbështetja e aktorëve shtetërorë, deputetëve etj përmes bashkëpunimit.

Instrumentet kërkimore

Metodologjia është mbështetur në kombinimin e metodave cilësore dhe sasiore si më poshtë:

1. Rishikim i literaturës dhe identifikimi i aktorëve të interesit
2. Workshope konsultuese online (3 uorkshope dhe 40 pjesëmarrës)
3. Sondazh i shtresëzua me pjesëmarrjen e 40 aktoreve të interesit që njohin problematikat
4. Analizimi i të dhënave të grumbulluara dhe përpilimi i raportit

2.1 Shqyrtimi i literaturës dhe puna kërkimore.

Ekspertët kanë identifikuar një sërë problematikash mjedisore të grupuara sipas tematikave (kategori të problematikave mjedisore) në tre qarqet e marra në analizë Lezhë, Durrës dhe Vlorë. Çështjet e identifikuara u realizuan nga hulumtimi i burimeve primare si, workshope konsultimi dhe hartëzimi) dhe burime sekondare (dokumente strategjike vendore, raporte kombëtare nga agjencitë shtetërore, shkrime investigative të realizuara nga organizata të shoqërisë civile, media investigative kombëtare Birn Albania, Reporter.al, Albanian Investigative Network, Citizens Channel apo media lokale). Si fillim, raporti identifikoi pesë (5) kategori të problematikave mjedisore kryesore (Tabela 2) dhe 30 problematika mjedisore brenda këtyre tematikave, që në fakt nuk përbëjnë një listë shteruese. Më shumë këto problematika janë një pikë nisje për konsultimin me aktorët e rajonit që çuan dhe në prioritizimin e tyre.

Tabela 2: Hartëzimi i kategorive mjedisore bregdetare

NR.	KATEGORI MJEDISOR	SHPJEGIM
1	Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur	- Në këtë kategori janë përfshirë ndotja nga mungesa e landfillëve sanitare, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe plastika.
2	Erozioni detar dhe tokësor	- Me erozion detar kemi parasysh avancimin e detit drejt tokës, erozionin që shkaktohet nga mungesa e bimësisë në bregdet, erozionit të lumenjve në deltat e tyre.
3	Ndotja detare dhe portuale	- Ndotja detare do të analizohet nga konteksti i derdhjes së hidrokarbureve, aksidenteve portuale dhe ndotjes në porte si rezultat i operacioneve portuale.
4	Shkatërrimi i biodiversitetit të rivierës	- Në këtë kategori do të analizohen problemet e lidhura me paligjshmërinë si gjuetia e paligjshme, peshkimi i paligjshëm, ndotja nga kultivimi dhe fermat e peshkimit apo eutrofikimi i lartë.
5	Konfliktet e zhvillimit bregdetar	- Në këtë kategori është analizuar reduktimi i zonave bregdetare kundrejt zhvillimit urban, zvogëlimi i hapësirave të mbrojtura dhe intensiteti i ndërtimeve në bregdet.

2.2 Përzgjedhja e aktorëve

Palët e interesit gjatë procesit të konsultimit u identifikuan në konsultim me ekipin e EcoAlbania-s dhe me mbështetjen e partnerëve të tyre në terren. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të agjencive qeveritare si AKZM, AKM, AKB, IKMT, organizata të shoqërisë civile, ekspertë dhe akademikë apo aktivistë në nivel qarku. Projekti ka identifikuar si aktorë të interesuar gjatë fazës para konsultimit rreth 90 aktorë të interesuar (50 burra dhe 40 gra) nga Vlora, Durrësi dhe Lezha, të cilët janë ftuar të marrin pjesë në procesin e konsultimit të realizuar online përmes tre workshopeve dhe 40 pjesëmarrësve.

2.3 Workshopi i hartëzimit dhe prioritizimi

Përmes tre takimeve ndëraktive të organizuara online, të cilat u realizuan për tre ditë (21-22-23 korrik 2021), me 40 pjesëmarrës (17 gra dhe 23 burra) nga qarqet përkatëse u aktivizuan dhe diskutuan shumë problematika kryesore mjedisore në zonat bregdetare. Si pasojë e zhvillimit të takimeve konsultuese dhe hartëzuese, por dhe punës hulumtuese paraprake u identifikuan 30 problematika kryesore në tre (3) qarqet konkrete (Lezhë, Durrës dhe Vlorë).

2.4 Sondazhi

Pas përfundimit të takimeve konsultuese online ekspertët hartuan një sondazh me qëllim mbledhjen e mendimit dhe informacionit të aktorëve të konsultuar, për prioritizimin e problematikave të identifikuara nga vetë ata.

Sondazhi u fokusua në prioritizimin e çështjeve më kryesore dhe shqetësuese për aktorët duke i vlerësuar dhe pikëzuar çdo alternativë të përzgjedhur. Përgjigjet e grumbulluara në formatin *google format*, kaluan në një proces filtrimi dhe rankimi, ku më pas u bë renditja e rezultateve sipas çdo qarku. Rezultatet dhe pikat përkatëse janë prezantuar në Shtojcën A të raportit.

2.5 Raporti i portofolit.

Më pas, ekipi i ekspertëve të EcoAlbania hartoi raportin e portofolit mjedisor bazuar mbi hulumtimin në tryezë, identifikimin e problemeve dhe shqyrtimin dhe prioritizimin e çështjeve mjedisore.

3. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE

3.1 Konteksti i përgjithshëm për zonën bregdetare

Shqipëria pozicionohet në pjesën Juglindore të Kontinentit European dhe është pjesë e Gadishullit të Ballkanit dhe shtrihet në perëndim të tij, me dalje të gjerë në det, nëpërmjet Adriatikut dhe Jonit, pjesë e pellgut të Mesdheut. Dalja e gjerë e Shqipërisë në detet Adriatik dhe Jon e bën atë pjesë të rëndësishme në udhëkryqet gjeopolitike të zhvillimeve historike të rajonit dhe në këtë kuadër, rëndësia e zonës bregdetare të vendit tonë ka qenë dhe do të mbetet strategjike.

Republika e Shqipërisë, ka një popullsi totale prej 2,83 milionë banorë³. Zona bregdetare ka shtrirje në 12 njësi të qeverisjes vendore⁴, si rrjedhojë e zbatimit të reformës administrative territoriale dhe popullsia që jeton në këto njësi është 427,634 banorë, sipas të dhënave të INSTAT-it. Ajo përbën 13.2% të popullsisë së vendit prej 2,83 milionë banorësh (po sipas të njëjtit burim). Popullsia në qytetet kryesore bregdetare si Durrësi (113,249 banorë), Vlora (79,513 banorë) dhe Saranda (17,233 banorë) përbëjnë rreth 49,1 % (209,995) të të gjithë popullsisë banuese në këto 12 njësi (427,634).

Bregdeti përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme të territorit, për shkak të pozicionit, vlerave natyrore, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore e historike që përmban. Dinamika e zhvillimeve me ritme të shpejta, sidomos pas viteve '90, nuk ka mundur të studime të mirëfillta në këtë zonë, të cilat do t'i paraprinin zhvillimit strategjik të saj, për të vendosur në funksion të zhvillimit pozitën e rëndësishme gjeografike në shkallë rajonale, si edhe për të përdorur me mençuri dhe përshtatshmëri burimet e shumta natyrore, kulturore dhe njerëzore.

Konkretisht, ndërtesat për qëllime banimi në njësitë vendore dhe administrative të Brezit Bregdetar përbëjnë 15% (106,577) të ndërtesave në rang kombëtar (598,267). Numri i banesave (jokolektive) në zonën bregdetare është 205,174 nga 1,012,062 banesa në rang kombëtar, që përbëjnë 17% të gjitha banesave⁵. Banesat e zakonshme të pabanuara në zonën bregdetare përbëjnë 23% të banesave të tilla në rang kombëtar, kurse ndërtesat për qëllime sezonale apo dytësore përbëjnë 34%⁶.

Ekosistemet bregdetare përbëjnë një mjedis natyror tërheqës dhe të rëndësishëm ekologjikisht, në shumë raste i mbrojtur sipas ligjeve ose marrëveshjeve ndërkombëtare. Për më tepër ato konsiderohen si një aset i madh ekonomik për Shqipërinë, duke qenë një nga forcat kryesore shtytëse për zhvillimin e turizmit. Përgjatë gjithë vijës bregdetare ekzistojnë një numër i lartë i zonave të mbrojtura si:

3 INSTAT. Popullsia e Shqipërisë 1 janar 2021; aksesuar në 4 korrik 2021; Popullsia e Shqipërisë | Instat

4 Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogzhinë, Divjakë, Fier, Himarë, Vlorë, Sarandë, Konispol

5 INSTAT, Regjistrimi I banesave në Shqipëri.Census 2011

6 INSTAT, Census 2011, po aty




Fig. 2

Kufiri tokësor dhe detar i Shqipërisë. Burimi: AKPT, 2016

1. **Parku Kombëtar i Karavastasë;**
2. **Parku i Llogarasë;**
3. **Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror Karaburun;**
4. **Parku Kombëtar i Butrintit;**
5. **Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror Kune-Vain-Tale;**
6. **Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan;**
7. **Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror Rrushkull;**
8. **Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror Pishë Poro;**
9. **Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror Patok, Fushëkuqe, Ishëm;**
10. **Peizazh i mbrojtur Vjosë-Nartë;**
11. **Peizazh i mbrojtur Bunë-Velipojë.**

Këto zona strehojnë pjesën më të madhe të biodiversitetit në Shqipëri si dhe shumë specie të rralla apo të kërcënuara me status të veçantë mbrojtjeje. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e këtyra zonave janë të njohura dhe të mbrojtura edhe ndërkombëtarisht nga konventa dhe marrëveshje të ndryshme, si Konventa Ramsar, Rrjeti Emerald, Konventa e Peizazheve etj.

Turizmi është një nga sektorët me rritjen më të shpejtë dhe kontribuesi kryesor për ekonominë shqiptare. Numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë në 2019 ishte 6,406,038⁷ dhe në 2020 ishte 2,657,818 me një rënie për shkak të pandemisë⁸. Ndërsa, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë shtatëmuajorit të 2021, është 2,846,881 duke u rritur me 2.4 herë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020⁹. Zonat bregdetare të Sarandës, Himarës, Vlorës, Durrësit dhe Shëngjinit janë ndër destinacionet turistike më të vizituara. Vit pas viti, sektori i turizmit po fiton një pjesë në rritje të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PBB) të vendit. PBB-ja shqiptare për frymë është 5,287 \$ (të dhëna për vitin 2020)¹⁰, ndërsa kontributi i përgjithshëm i turizmit në ekonomi vlerësohet në 27% për vitin 2019 me afërsisht 4.8 miliardë USD¹¹.

3.2 Kategoritë mjedisore dhe problemet

Zhvillimet e vrullshme urbane kanë ndikuar në pastërtinë e bregdetit. Deti Adriatik dhe Jon janë bërë pritësit e shkarkimeve urbane, industriale, bujqësore dhe blegtorale. Derdhjet e shumta jashtë çdo kontrolli me pesticide dhe kimikate të papërpunuara të tokave bujqësore, mbetjet organike të cilat përmbajnë fosfor e azot, viruse e baktere patogjene, metale të rënda etj. si dhe rritja e numrit të banorëve në disa qendra urbane e ka bërë të pamundur procesin e vetëpastrimit të detit.

Përveç këtyre faktorëve, të cilët duhet të ishin nën menaxhimin dhe kontrollin e qeverisjes vendore, listës së gjatë i shtohen edhe mbeturinat e pafundme të lëna kudo përgjatë bregdetit, përfshi këtu edhe një ndër armiqtë kryesorë të gjallesave detare, mbetjet plastike.

7 INSTAT. Hyrja e shtetasve në Shqipëri 2014-2020, aksesuar 4 korrik 2021; Turizmi | Instat

8 INSTAT, po aty

9 INSTAT, po aty. lëvizjet-e-shtetasve-në-shqipëri-korrik-2021.pdf (instat.gov.al)

10 World Data. Albania Gross Domestic per capita. Albania GDP per capita, 1980-2020 - knoema.com

11 Po aty. Albania Contribution of travel and tourism to GDP, 1995-2019 - knoema.com

Ndotja e lumenjve, sidomos në zonat rurale ku luginat e tyre jo rrallë janë venddepozitimet e mbetjeve, përbëjnë një tjetër burim ndotjeje. Edhe ndotja e ujërave nëntokësore jep ndikimin e saj në këtë vorbull të madhe.

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se bregdeti shqiptar është në rrezik si pasojë e grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, shkarkimit nga lumenjtë që përshkojnë zonat urbane dhe mos trajtimi i ujërave të ndotur urban¹². Ndërsa, cilësia e ujit të plazheve në vend, ende është nën kufijtë e ndotjes, dhe kjo nuk vjen për shkak të menaxhimit të kujdesshëm të tyre, por thjesht nga frekuentimi jo masiv.

Pavarësisht raportimeve nga media për raste të ndotjes së lartë të plazheve kryesisht si pasojë e aktivitetit njerëzor, cilësia e ujërave të banjës sipas AKM-së, ka një situatë pozitive. Nga të dhënat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Raportit të "Bathing Water Quality 2020", ku maten 119 pika turistike në vend situata paraqitet si më poshtë:

- **91 pika kanë cilësi të shkëlqyer;**
- **21 kanë cilësi të mirë;**
- **5 kanë cilësi të varfër;**
- **2 kanë cilësi të mjaftueshme¹³;**

Plazhet më të ndotura janë në Durrës (Plazhi i Zhironit dhe Plazhi pas Kanalit Plepa). Ndërkohë që plazhet me cilësi të shkëlqyer paraqiten Borshi, Dhërmiu, Shëngjini, Velipoja e Himara¹⁴.



Fig. 3

Ndotja në deltën e Lumit Ishëm, Qarku Durrës

¹² Green27. The alternative view of environmental progress. Albania's negotiations with EU and Chapter 27. P.63

¹³ EEA. Bathing Water Quality 2020. State of bathing water – European Environment Agency (europa.eu)

¹⁴ AKM. Raporti i Gjendjes në Mjedisit 2020. Tiranë, 2021; www.akm.gov.al/bregdeti

Në këtë kontekst, ekspertët e grupuan gjithë problematikën të lidhur me rivierën bregdetare në tre qarqe (Vlorë, Durrës dhe Lezhë) dhe në pesë kategori kryesore. Secila nga kategorit mjedisore përmbledh një larmi problematikash specifike për secilin qark të cilat janë trajtuar hollësisht në seksionin vijues.

3.3 Ndotja urbane e ujërave bregdetare

Burimi prioritar i ndotjes në Shqipëri janë mbetjet e ngurta urbane. Bazuar në një vlerësim të ndërmarrë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me mbështetjen e programit për qeverisjen vendore të Ambasadës Zviceriane¹⁵ për venddepozitimet e paligjshme, jo sanitare dhe ato që kërkojnë rehabilitim, Shqipëria ka 199 venddepozitime të tilla. Po i njëjti vlerësim rekomandon se 44 venddepozitime kërkojnë rehabilitim me një vlerë të përafërt prej 2,8 Milion EUR; 62 venddepozitime duhet të mbyllen dhe kërkojnë një investim me vlerë 2,85 Milion EUR dhe 93 venddepozitime duhet të zhvendosen në vend-depozitime të tjera të ligjshme ose që janë në kushte sanitare dhe kjo kërkon një investim prej 1,35 Milion EUR. Situata në qarqet bregdetare të marra si raste studimore, paraqitet me 43 venddepozitime ku 13 kërkojnë mbyllje dhe 27 prej tyre largim në një landfill të afërt sanitar.




Fig. 4

Harta e Venddepozitimeve në Shqipëri, 2018

Në Shqipëri akoma nuk ka një landfill sanitar në bregdet dhe mbeturinat hidhen në vendgrumbullime afër lumenjve dhe përrenjve ose pranë detit. Përfundimisht, shumica e këtyre mbetjeve derdhen në Adriatik dhe Jon duke ndotur plazhet dhe mjedisin detar. Ky problem është i një rëndësie rajonale, pasi rrymat mbizotëruese të detit në Adriatik mbartin mbeturina drejt brigjeve të Malit të Zi dhe Kroacisë¹⁶.

Menaxhimi i mbetjeve bashkiake është në hapa shumë fillestarë, ku ka shumë pak riciklim dhe

¹⁵ DLDP. Dumpsite mitigation study. Tiranë, 2018

¹⁶ Tirana Today. Ndotja/Shqipëria fundos Kroacinë, bregdeti i Adriatikut në mjerim; 18.03.2018: <https://tiranatoday.al/ndotjashqiperia-fundos-kroacine-bregdeti-adriatikut-ne-mjerim-video/>

kryesisht përdoret depozitimi në vendepozitime/landfille¹⁷. Nuk praktikohet ndarja e mbetjeve në burim dhe aktualisht mbledhja e tyre bëhet me një sistem grumbullimi nga kazanët, kryesisht 1,1 m³, të vendosur anës trotuareve. Disa nga kazanët e mbetjeve dhe automjetet që i mbledhin janë shumë të amortizuara dhe në gjendje jo të mirë. Mbetjet transportohen në vendet e depozitimit, të cilat në numrin më të madh të tyre janë jashtë standardeve dhe gjenden në vende të papërshtatshme dhe të paplanifikuara.



Fig. 5

Shkarkimet e ujërave të përdorur në bregdetin e Durrësit © "e përditshma", 2018

Si rrjedhojë, deltat lumore reflektojnë situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend ku shumica e deltave janë një emergjencë mjedisore për shkak të ndotjes së akumuluar dhe prurjeve përgjatë gjithë zonave të urbanizuara. Delta e Ishmit, në Durrës është një nga pikat e nxehta të ndotjes ku shtresa të tëra me mbetje plastike, mbetje spitalore janë akumuluar në bregdet. Nga ana tjetër, depozitimi i mbetjeve urbane në zona bregdetare pa kushte sanitare dhe mjedisore vazhdon të jetë një praktikë. Në Spille, problemi i mbetjeve vazhdon të prodhojë krim mjedisor për shkak të djegjeve në natyrë¹⁸. I njëjti problem paraqitet përgjatë gjithë vijës bregdetare ku qarku i Durrësit është më i spikaturit për shkak të pamundësisë së një venddepozitimi sanitar¹⁹. Siç tregohet në Tabelën 3, të gjitha Bashkitë që përbëjnë brezin bregdetar nuk kanë një landfill sanitar për depozitimin e mbetjeve urbane apo incinerator, që dëshmon dhe situatën kaotike të mbetjeve urbane shfaqur gjatë sezonit turistik 2021 sidomos në bashkinë Durrës.

17 Green27. The alternative view of environmental progress. Albania's negotiations with EU and Chapter 27.

18 Krimi mjedisor në Spille/ Policia nuk procedon zyrtarët vendorë, Bashkia mohon landfillin e paligjshëm. Aksesuar në 5 Korrik 2021 <https://www.balkanw4eb.com/krimi-mjedisor-ne-spille-policia-nuk-procedon-zyrtaret-vendore-bashkia-mohon-landfillin-e-paligjshem/>

19 BIRN; EXIT

Tabela 3: Forma e menaxhimit të mbetjeve urbane sipas njësive vendore²⁰

QA-RKU	BASHKIA	LAND-FILL	INCINERATOR	STACION TRASFERIMI	QENDER RICIKLIMI	VENDDEPOZITIM
Vlorë	Konispol					X
	Ksamil			X		
	Sarandë				X	X
	Himarë			X	X	X
	Orikum					X
	Vlorë					X
Durrës	Durrës					X
	Shijak					X
	Kruja					x
Lezhë	Lezhë			X	X	X
	Shëngjin					X
	Kurbin					X

Nga ana tjetër, në shumicën e rasteve ujërat e zeza të pa trajtuara shkarkohen direkt në det ose në trupat ujorë të lidhur me detin. Si rezultat, ndotja bakteriologjike dhe kimike në ujërat bregdetare është e lartë dhe paraqet rreziqe shëndetësore për popullatën dhe turistët. Sipas (AKM, 2020) monitorimi i ndikimit të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare është realizuar në qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë²¹. Përzgjedhja e stacioneve të monitorimit është përcaktuar në legjislacionin shqiptar VKM Nr.177 dt.31.03.2005, që janë të njëjta me ato të Direktivës së Komunitetit Evropian. Situata paraqitet me vlera të parametrave mjedisore të matur përtej normave të lejuara që përcakton legjislacioninë disa pika monitorimi si në Porto Romano, Currila, Kanali Plepa - Shkëmbi i Kavajës (Durrës); Hidrovori-Pylli i Sodës, në det 20 m pas stacionit të pompimit - Pylli i Sodës, Plazhi i Ri - Vlorë, Shkolla e Marinës (Vlorë).

3.4 Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike

Zhvillimi i bregdetit prej turizmit dhe urbanizimit është intensifikuar gjatë viteve të fundit. Kjo ka sjellë rritje të popullsisë, e cila shkakton degradimin e ekosistemeve, rritjen e erozionit, shtimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura në det, në mungesë të ndërtimit të rrjeteve adekuate të kanalizimit, humbjen dhe fragmentarizimin e habitateve natyrore, si dhe rrezikimin e specieve në zhdukje.

²⁰ AKM 2020

²¹ AKM, 2020



Fig. 6

Avancimi i detit drejt plazhit si pasojë e erozionit detar në bregdetin e Semanit © David Galjaard "Gazeta liria", 2017

Një faktor shumë i rëndësishëm që rrezikon ekosistemet ujore është ndryshimi klimatik, i cili i ka dhënë efektet e tij tashmë në Shqipëri. Pasojat e ndryshimit të klimës për zonën bregdetare mund të jenë shumë të rënda. Për shembull, nivelet globale të detit sipas projeksioneve janë parashikuar të rriten me 0,28-0,98 metra²². Vetëm ky efekt i ndryshimeve klimatike do të sjellë pasoja të mëdha në zonën bregdetare nëpërmjet humbjes së sipërfaqes së tokës, shkatërrimit të ekosistemeve dhe ndikimit në veprimtarinë ekonomike të qyteteve e fshatrave bregdetare.

Disa nga këto ndryshime janë: rritja e temperaturave të ajrit dhe e sipërfaqes detare; ndryshimet mesatare dhe reshjet ekstreme; ndryshimet në frekuencën e intensitetit të stuhive; rritja e nivelit të detit; acidifikimi në oqean. Aktualisht, disa nga territoret e rrezikuara nga faktorët e erozionit detar në bregdet, janë si vijon:

Bashkia Lezhë, ku si zonë e kërcënuar shihet ajo e grykëderdhjes së lumit Drin nga Balldreni i Ri deri në zonën e Tales, nga erozioni detar dhe përmytjet e bregdetit (nga ishull Shëngjini) deri në grykëderdhjen e lumit Mat. Gjithashtu, futja e ujit të kripur në zonën e ishull-Shëngjinit dhe erozioni detar nga grykëderdhja e lumit Drin deri në grykëderdhjen e lumit Mat rrezikojnë përmytjen e tij.²³

Bashkia Durrës rrezikohet nga përmytjet e lumit Ishëm. Ndërsa, baseni i lumit nga Derveni deri në grykëderdhje, rrezikohet nga përmytjet e lumit Erzen. Po kështu, rrezikohet nga

²² <https://www.climate.gov/news-features/understanding-climate/climate-change-global-sea-level>

²³ Report "Identification and Implementation of Adaptation Response Measures in the Drini - Mati River Deltas" (UNDP 2015)

përmytjet detare zona nga grykëderdhja e lumit Erzen deri te Rina (Kepi i Rodonit) dhe nga Kepi i Rodonit deri në Porto Romano. E njëjta situatë është nga erozioni detar Kepi i Rodonit në pjesën jugore dhe Bishti i Pallës në zonën jugore dhe rrëshqitje ka përgjatë Kepit të Rodonit nga Shkallnuri deri në Seferaj.²⁴

Gjithashtu zonat si Velipojë, Kune-Vain, Patok-Fushë Kuqe, Rrushkull-Gjiri i Lalëzit, Karavasta, Pishë-Poro Fier, Nartë dhe grykëderdhjet e lumenjve, rrezikohen po njësoj nga erozioni bregdetar.²⁵

Bashkia Vlorë rrezikon nga erozioni detar dhe përmytjet e bregdetit nga grykëderdhja e Vjosës deri në Triport. Pjesë e basenit të lumit Vjosë nga pjesa e bashkisë Vlorë rrezikohet nga përmytjet lumore, ndërsa në pjesën jugore të qytetit të Vlorës pusët karstike rrezikohen nga futja e ujit të kripur nga deti. Zona bregdetare rrezikohet nga rrëshqitjet masive; nga Kepi i Stillos deri në Palasë zona bregdetare është e rrezikuar nga erozioni detar.²⁶

Në bashkinë Himarë, bregdeti është i rrezikuar nga erozioni detar ku zona bregdetare rrezikohet nga rrëshqitjet masive. Në gjirin e Palermos dhe në Qeparo rrezikohet hyrja e ujit të kripur nga deti ndërsa nga Borshi deri në Lukovë ka rrëshqitje.²⁷

Bashkia Sarandë, nga Nivica deri në Sarandë rrezikohet nga rrëshqitjet dhe vija bregdetare rrezikohet nga erozioni detar.

Ndërsa, në Bashkinë Konispol, vija bregdetare është e rrezikuar nga erozioni detar dhe zona bregdetare rrezikohet nga rrëshqitjet.²⁸

3.5 Ndotja detare dhe portuale

Tregtia portuale është një sektor me rritje në Shqipëri dhe një burim ekonomik i rëndësishëm kombëtar dhe ndërkombëtar. Qeveria shqiptare ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike sektoriale në fushën e tregtisë detare dhe aktivitetit portual siç janë Plani Kombëtar i Transportit, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Plan Buxheti afat-mesëm. Shqipëria është anëtare e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit 1982, kështu që ka detyrimin të mbrojtë dhe të ruajë mjedisin detar ndaj ndotjes. Ndotja në vetvete nënkupton futjen nga njeriu, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të lëndëve ose energjisë në mjedisin detar, të cilat dëmtojnë burimet e detit dhe të bregdetit, ulin cilësinë e ujit të detit, rrezikojnë shëndetin e njeriut, pengojnë veprimtaritë detare dhe peshkimin.

Shqipëria ka hartuar Planin Kombëtar për përgjigjen ndaj ndotjes detare që mund të jetë ajo hidrokarbure apo ndotja portuale si pasojë e operacioneve portuale²⁹.

24 AKPT, 2015, fq. 76

25 Report "Identification and Implementation of Adaptation Response Measures in the Drini - Mati River Deltas" (UNDP 2015)

26 AKPT, 2015, fq. 77

27 (AKPT, 2015) fq.76-77

28 Po aty. Fq.77

29 Vendim i KM nr. 480, datë 25.7.2012. Plani është i formësuar në tre (3) nivele: i) niveli 1 kombëtar ku përgjegjës është Qendra Ndër-institucionale Operacionale Detare (QNOD); ii) niveli 2 rajonal ku përfshihet Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe roja bregdetare, iii) niveli 3 lokal ku përfshihen autoritetet portuale, bashkitë, agjencitë rajonale të mjedisit.

3.5.1 Ndotja hidrokarbure

Ndotjet e shkaktuara nga hidrokarburet kanë qenë të shpeshta në bregdetin shqiptar³⁰. Ndotja hidrokarbure shkaktohet nga dy burime kryesore: ndotja si pasojë e aksidenteve industriale në portet hidrokarbure dhe ndotja nga derdhjet e naftës në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës përmes lumenjve të Vjosës apo Semanit. Tabela 4, paraqet disa nga rastet mediatike të grumbulluara gjatë 5 viteve të fundit ku vërehet se aksidentet industriale dominojnë në ndotjen bregdetare. Por është me rëndësi të përmendet se keqmenaxhimi i shkarkimeve hidrokarbure në lumenjtë e Semanit, Erzenit dhe Vjosës është një rrezik permanent në ndotjen e ujërave.



Fig. 7

Avancimi i detit drejt plazhit si pasojë e erozionit detar në bregdetin e Semanit © Megi Zonja "ATSH", 2018

Për më tepër duket se planet qeveritare për avancimin e kthimit të portit të Vlorës si port energjetik po marrin jetë. Gjatë 2021, qeveria shqiptare ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes Shqipërisë e SHBA-së përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Exxon Mobil&Excelerate Energy për futjen e gazit të lëngshëm natyror nga Amerika në Shqipëri.³¹

30 Albania Searches for Seashore Oil Polluter | Balkan Insight

31 Tvklan. Nënshkruhet marrëveshja për TEC-in, çfarë do të ndodhë në Vlorë. 12 Mars 2021 <https://tvklan.al/nenshkruhet-marreveshja-per-tec-in-cfare-do-te-ndodhe-ne-vlore/>

32 <https://www.news24.com/news24/green/nees/oil-spill-pollutes-albanian-coast-20160524>

33 <https://www.reporter.al/defekt-te-petrolifera-nafta-bruto-derdhet-ne-bregdetin-e-vlores/>

34 Oil Pollution Threatens Europe's Last Wild River | Balkan Insight

35 <https://ew.reporter.al/krimi-mjedisor-ne-porto-romano-autoritetet-bejne-nje-sy-qorr-ndaj-derdhjes-se-naftes-ne-det/>

Tabela 4: Rastet e ndotjes hidrokarbure të raportuar nga media.

#	RASTET E RAPORTUARA TË NDOTJES	VENDNDODHJA	BURIMI	VITI
1	Ndotja e Plazhit të Durrësit	Durrës,	Balkan Insight	2015
2	Derdhja e naftës në Plazhin e Zvernecit	Zvernec, Vlorë	News 24 ³²	24.05.2016
3	Defekt te Petrolifera, nafta bruto derdhet në bregdetin e Vlorës	Zvernec, Vlorë	Reporter.al ³³	24.05.2016
4	Ndotja e Lumit Vjosa nga shkarkimet hidrokarbure	Grykëderdhja Vjosës	Balkan Insights ³⁴	2018
5	Krimi mjedisor në Porto Romano	Porto Romano	Reporter.al ³⁵	20.04.2020

Por, sipas Qendrës Ndër-institucionale Operacionale Detare (QNOD)³⁶ e cila merret me koordinimin e institucioneve të shumta menaxhuese, inspektuese dhe kontrolluese në det, statistikën (viti 2018-2020) për sa i përket aktiviteteve të paligjshme si ndotja detare dhe peshkimi i paligjshëm kanë ndikim negativ në ujërat dhe ekosistemet detare dhe raportohen si në Tabelën 5 më poshtë:

Tabela 5: Rastet e ndotjes detare dhe peshkimit të paligjshëm të raportuara nga QNOD

	VITI	NUMRI I RASTEVE
NDOTJE DETARE	2018	3 raste
	2019	12 raste
	2020	4 raste
Peshkim i paligjshëm	2018	22 raste
	2019	23 raste
	2020	10 raste

Siç shikohet qartë dhe nga statistikën institucionale, ka një dis-balancë nga ajo që raportohet në media dhe çfarë janë statistika institucionale.

3.5.2 Aktiviteti operacional në porte

Të dhënat nga INSTAT dëshmojnë që volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin qershor 2021 është 412 mijë ton, duke u rritur 9.6 %, krahasuar me qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve qershor për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur 15.7%.³⁷ Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2,345.3 mijë ton, duke u rritur me

³⁶ VKM Nr.954, datë 30.9.2009 për organizimin, strukturën, funksionimin e qendrës ndër-institucionale operacionale detare (qnod) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det.

³⁷ INSTAT, Statistikat e transportit, Qershor 2021; aksesuar 29 qershor 2021; <http://ew.instat.gov.al/media/8747/statistikat-e-transportit-qershor-2021-1.pdf>

15.4 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.³⁸ Aktiviteti i lartë tregtar në porte dhe flota relativisht e vjetër (Figura 8) për vendin tonë përbëjnë një risk të shtuar në aspektin e menaxhimit portual të ujërave të ndotur, mbetjeve urbane nga anijet dhe ujërat e balastës, ku porti i Durrësit mban peshën më të madhe si paraqitet dhe në Figurën 8.




Fig. 8

Flota detare në Shqipëri sipas porteve³⁹

Kjo vërtetohet dhe nga fakti që Memorandumi i Parisit⁴⁰ ka renditur anijet shqiptare në listën e zezë⁴¹ për shkak të riskut të lartë që ato mbartin.

Shqipëria ka 4 porte shtetërore (Shëngjin, Durrës, Saranda dhe Vlora), tre porte private (Porti Vlora 1 - terminali i naftës i menaxhuar nga Petrolifera; Porti i hidrokarbureve Porto Romano⁴², dhe Porti i Naftës i ARMO's në Gjirin e Vlorës), triporti për anijet e peshkimit Vlorë, dy unaza karburanti që operojnë në Gjirin e Vlorës dhe Termocentrali i Vlorës (KESH sh.a.).

3.6 Shkatërrimi i biodiversitetit

Në identifikimin e problematikës së biodiversitetit, ekspertët përdorën tre indikatorë kryesore, me qëllim përcaktimin e një liste sa më përfaqësuese problematikash si vijon: rreziku nga eutrofikimi⁴³ i ujërave dhe biodiversitetit të detit, prezenca e specieve invazive dhe paligjshmëria.

3.6.1 Eutrofikimi⁴⁴ nga akuakultura

Peshkimi detar është sektori më i rëndësishëm i industrisë së peshkimit, por peshkimi lagunor dhe i brendshëm janë gjithashtu të rëndësishëm. Kategoritë ujore të peshkimit janë: det, bregdet, laguna, ujëra të brendshme, akuakulturë dhe molusqe. Sipas të dhënave më të fundit

38 Instat, po aty

39 MBZHR, 2020

40 Memorandumi i Parisit është një mekanizëm që kryen inspektimet mbi standardet e anijeve në Europë <https://ew.parismou.org/detentions-banning/detentionlists-2021>



41 Monitor. Anijet shqiptare, si u futën në listën e zezë dhe plani për daljen. 8.7.2021; <https://ew.monitor.al/anijet-shqiptare-si-u-futen-ne-listen-e-zeze-dhe-plani-per-daljen/>

42 <https://portimbm.al/safety-and-environment-hse/>

43 Eutrofikimi është përqendrimi i lartë i lëndëve ushqyese në një trup të ujit. Këto ushqyes - zakonisht azot dhe fosfor - janë ushqim për organizmat ujorë si algat, plankton ose mikroorganizma të tjerë. Eutrofikimi mund të ndodhë edhe jashtë ujit; për shembull, tokat mund të jenë eutrofike kur ata kanë nivele të larta të azotit, fosforit ose ushqyeseve të tjerë.

44 Po aty

nga Ministria e Bujqësisë, prodhimi i kapur në vitin 2020 ishte 16,892 ton.⁴⁵ Kategoritë kryesore që zënë përqindjen më të lartë të peshkimit janë, “Akuakultura” me 52.09 % dhe peshkimi “Detar” me 26.76 %, pasuar nga “Ujërat e brendshme” me 16,83 %, ndaj prodhimit gjithsej.



Flota shqiptare e peshkimit (Figura 5) ndodhet aktualisht në katër porte: Durrës, Vlorë, Shëngjini dhe Sarandë ku janë të punësuar rreth 1 870 persona. Për më tepër, 1,000 peshkatarë janë angazhuar drejtpërdrejt në peshkimin e brendshëm në 2018. Në vitin 2018 akuakultura prodhoi 6,258 ton, të përbërë nga peshq të detit (77 %), troftë (13 %) dhe midhje (10 %). Aktualisht janë 24 ferma peshqish detarë për levrek dhe karkaleca deti, 22 ferma troftash, disa ndërmarrje që kultivojnë midhje në liqenin e Butrintit dhe 4 ferma për rasatë krapë që rriten në rezervuare natyrore dhe artificiale të brendshme. Akuakultura siguroi punësime direkte për 620 persona në 2018.⁴⁶

Në vitin 2017 importet e peshkut dhe produkteve të peshkimit u vlerësuan në 75,7 milion dollarë.⁴⁷ Eksportet ishin me vlerë 94 milion dollarë, me aquge të përgatitura dhe të konservuara që përfaqësojnë pjesën më të madhe të eksporteve. Konsumi i peshkut në Shqipëri është rritur gradualisht dhe konsumi për frymë vlerësohet të jetë rreth 5.3 kg/vit në vitin 2016.⁴⁸ Riprodhimi dhe popullatat e përqendruara të peshqve në fermat e akuakulturës, përben një

45 Instat, Statistikat e Peshkimit 2020. Aksesuar në 5 shtator 2021; www.instat.gov.al

46 FAO. Fisheries and aquaculture in Albania; FAO Fisheries & Aquaculture - Fishery and Aquaculture Country Profiles - The Republic of Albania

47 FAO. Fisheries and aquaculture in Albania; FAO Fisheries & Aquaculture - Fishery and Aquaculture Country Profiles - The Republic of Albania

48 Këto të dhëna bazohen në statistikën e përgatitura nga Njësia e Informacionit, të Dhënave dhe Statistikave të Peshkimit të FAO -s dhe të shpërndara në vitin 2020. Grafikët bazohen në të njëjtin burim, por këto përditësohen automatikisht çdo vit me statistikën më të fundit. Për vendin tonë këto janë të dhënat më të fundit.

nga elementët kryesorë të ndotjes së ujërave detare.

Konkretisht, ndikimi i akuakulturës intensive përgjatë rivierës është i lartë për shkak të antibiotikut të përdorur dhe nivelit të lartë të përqendrimit të ndotësve si pasojë e mbetjeve të ushqimit koncentrat apo edhe të ekskrementeve të popullatave të peshqve me densitet të lartë në zonë të cilat çlirohen në zonën përreth. Një efekt tjetër negativ në fermat e akuakulturës së përqendruar është edhe fenomeni i ndotjes gjenetike. Ky fenomen konsiston në kryqëmbimin aksidental të specieve të peshqve të egër me popullatat e peshqve të përdorur në akuakulturë. Sidomos më i shpeshtë ky fenomen është i pranishëm në speciet që kanë aftësi të lartë hibridizimi si troftat, kocat etj.

3.6.2 Speciet evazive

Një nga problemet kryesore të identifikuara për ekosistemin detar lidhet me problematikën e ujërave të balastrës (nga anijet) së transportit detar që njihen si një nga vektorët kryesorë për shpërhapjen e specieve invazive në brezin bregdetar. Gaforja blu (*Callinectes sapidus*) është një lloj gaforeje e cilësuar si lloj alien Lesepsian e ardhur nga Deti i Kuq përmes Kanalit të Suezit.

Fillimisht, ky lloj është hasur në bregdetin verior të Shqipërisë në Lezhë në lagunën e Kune-Vain rreth 10-12 vjet më parë. Këtu gaforja ka gjetur kushtet e përshtatshme dhe në mungesë të grabitqarëve natyrorë e duke mos qenë fillimisht e preferuar për konsum, është shtuar në mënyrë eksponenciale jo vetëm në lagunën e Kune-Vainit por edhe është shpërhapur në pothuajse të gjithë bregdetin shqiptar.

Në këtë mënyrë gaforrja ka pushtuar habitatet që më parë ziheshin nga speciet autoktone si gaforrja e zakonshme e Mesdheut (*Carcinus mediterranea*).

Në këtë mënyrë gaforrja ka shkaktuar jo pak çrregullime në ekuilibrat ekologjikë të rrjetave trofike të lagunave bregdetare në Shqipëri. Ashtu si gaforrja blu edhe një numër i llojeve të tjera aliene-invazive janë të pranishme tashmë në ujërat detare në Shqipëri.

Ndryshimi i cilësisë së ujërave dhe i elementeve klimatikë kanë mundësuar rritjen e konkurrenshërisë së fanerogameve⁴⁹ detare të tjera kundër barishtes autoktone të detit (*Posidonia oceanica*). Kjo e fundit është specia habitat-formuese që gjendet në fundin e detit në të gjithë pellgun e Mesdheut e që strehon më shumë se 40% të gjithë botës detare⁵⁰. Për më tepër livadhet e *Posidonias* janë fundamentale në prodhimin e oksigjenit duke mundësuar mbështetjen e jetës jo-fotosintetike nën ujë. Për shkak të përmendura më sipër, livadhet e *Posidonias* gjithnjë e më shumë janë duke u reduktuar e duke u lënë vendin specieve jo-autoktone si *Zostera noltii*, *Cymodocea nodosa* etj., të cilat në asnjë rast nuk mund të zëvendësojnë kontributin dhe rolin e *Posidonias* në ekosistem.

3.6.3 Paligjshmëria

Në Velipojë, Kune-Vain, Patok-Fushë Kuqe, Rrushkull, Karavasta, Pishë-Poro, Fier, Nartë, Butrint, Rrushkull, Vjosë-Nartë etj., ushtrohet gjueti e paligjshme nga gjuetarë vendas

49 Bime enësore të larta që jetojnë në fundin e detit

50 Bota e gjallë nënujore detare

dhe të huaj. Mbipeshkimi, peshkim i paligjshëm dhe përdorim i mjeteve të ndaluara, janë fenomene që hasen shpesh përgjatë bregdetit. Po njësoj, praktikat e peshkimit të paligjshëm si dinamit, elektricitet apo gërmimit të fundit të detit nga flota e peshkimit vetëm 500 m larg vijës bregdetare shkaktojnë shkatërrimin e biodiversitetit detar.⁵¹ Statistikat e peshkimit të paligjshëm janë relativisht të ulëta me vetëm 10 raste në 2020 (Tabela 5), por nga konsultimet e realizuara gjatë workshop-ve situata paraqitet më serioze.

3.7 SFIDAT E ZHVILLIMIT BREGDETAR

Presioni i zhvillimeve bregdetare është një nga sfidat kryesore kombëtare përgjatë vijës bregdetare. Numri i madh i ndërtimeve pa leje apo prishja e tyre sipas fushatave të ndryshme, para apo pas sezonit turistik kanë shoqëruar politikën ditore në Shqipëri në 30 vitet e fundit. Shpesh ky presion i shtuar ka gjeneruar konflikte të shumta jo vetëm në rrafshin pronësor por dhe zhvillimor të tipit: turizëm apo urbanizim, mjedis apo ndërtim, zhvillim i qëndrueshëm apo ekonomi vertikale, turizëm familjar apo turizëm elitare. Për identifikimin e problematikës lidhur me konflikte zhvillimore është me rëndësi analiza e dy treguesve kryesore: a) intensiteti i ndërtimeve në bregdet në kohë në harkun 1990-2020 dhe b) shtimi ose pakësimi i sipërfaqeve të 9 zonave të mbrojtura që shtrihen përgjatë vijës gjithë bregdetare.

3.7.1 Urbanizimi dhe intensiteti i ndërtimeve

Përgjatë vijës bregdetare vërehet qartë formimi i një sistemi linear urban dhe shërbimesh, pothuajse i pandërprerë, i cili fillon në Shkodër dhe ndjek linjën e sistemit rrugor kryesor, përshkon tejpërtej Shqipërinë në Velipojë, Shëngjin, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë për të mbërritur deri në jug të saj, në zonat e Ksamilit dhe Bashkisë Konispol. Paralelisht me nevojat për strehim e punësim dhe me rritjen e të ardhurave ekonomike, një dukuri e dytë në rajonin bregdetar, lidhet me kërkesën për banesa të dyta ose shtëpi pushimi, për shtresat e shoqërisë me të ardhura mbi mesataren. Ky fenomen shoqërohet edhe me kërkesat për infrastrukturë turistike të shtuar dhe me standarde bashkëkohore.

Urbanizimi i brezit bregdetar ka qenë gjithmonë në presion nga ndërtimet e parregulluara, të paligjshme ose përtej planeve rregulluese. Të gjitha bashkitë (Lezha, Vlora, Himara, Saranda, Konispoli) që shtrihen në vijën bregdetare kanë miratuar planet e tyre vendore duke përcaktuar dhe zonat zhvillimore dhe hapësirat përkatëse në vitin 2017.⁵² Bashkia Durrës është akoma në fazën e dakordësimit dhe rishikimit të dokumentit.⁵³

Sipas Planit të Integruar Sektorial të Bregdetit, Bashkia Durrës klasifikohet si Bashki me intensitet të lartë urbanizimi me një rritje prej 36.91% të urbanizimit të saj krahasuar me vitin 2000.⁵⁴ Bashkia Lezhë kryesisht Shëngjini klasifikohet si bashki me intensitet të lartë dhe të mesëm ndërtimi me rritje prej 16.03% të kërkesës së ndërtimeve. Bashkia Vlorë klasifikohen

51 FAO. Fisheries and aquaculture in Albania; FAO Fisheries & Aquaculture - Fishery and Aquaculture Country Profiles - The Republic of Albania

52 Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Plane të detajuara vendore. Aksesuar më 1 gusht 2021; Plane të Përgjithshme Vendore (planifikimi.gov.al)

53 AKPT, po aty.

54 PINS Bregdeti, fq.51

si bashki me dendësi të lartë dhe të mesme urbanizimi me rritje prej 10.96% të urbanizimit.⁵⁵ Ndërsa Bashkia Himarë, Sarandë dhe Konispol më dendësi të ulët urbanizimi.




Fig. 11

Duke analizuar planet vendore të zhvillimit për 5 nga 6 bashkitë bregdetare në analizë sipas figurës 5 vërejmë se të gjitha bashkitë kanë propozuar rritje të urbanizimit ku kryeson Lezha me 807 ha. Në total hapësira e propozuar për urbanizmin në bashkitë Himarë, Vlorë, Sarandë, Konispol dhe Lezhë shkon në 1,895 ha. Kjo hapësirë është reduktuar nga sistemi natyror dhe ai ujor siç vërehet nga figura 5, në bashkinë Lezhë dhe kryesisht në dëm të Lagunave të Kune-Vain-Tales.

Presioni për urbanizim në vijën bregdetare është i madh dhe kjo vërehet në rishikimin e planeve zhvillimore për Bashkinë Himarë, Vlorë dhe Lezhë të cilat në vitin 2020 kanë kërkuar shtim të sipërfaqeve urbane. Megjithatë është e vështirë për të patur një panoramë të saktë statistikore dhe krahasimore për urbanizmin në bregdet duke qenë se censusi i banesave ka nisur në vitin 2020 dhe rezultatet e para do të dalin në vitin 2022.⁵⁷ Ajo çka mund të themi është se ekziston një presioni i lartë për ndërtime, resorte turistike në bashkinë Himarë, Vlorë dhe Lezhë (Shëngjin) duke përdorur tokën bujqësore dhe sistemin natyror ose zonat e mbrojtura.

3.7.2 Ndryshimi i zonave të mbrojtura

Në brezin bregdetar shtrihen një numër i lartë i zonave të mbrojtura me një sipërfaqe totale prej rreth 120 mijë hektarësh, ku përfshihen Parqe Kombëtare (4 me sip. 46,020 ha); rezervate të menaxhuar apo parqe natyrore (4 me sip. 51,282 ha) dhe Peizazhe të mbrojtura (1 me sip. 23,027 ha); sipas tabelës 6 më poshtë. Në total janë 9 zona të tilla që sipas vendimeve të shpalljes së tyre përbëjnë një territor prej 119,401.5 ha ose 23.6% të gjithë sipërfaqes së rrjetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri.

55 PINS, Bregdeti, fq.51


56 AKPT, Planet Zhvillimore Vendore 2017 për bashkitë në studim. www.akpt.gov.al/pzhv

57 Instat, Census i ndërtesave 2020. www.instat.gov.al

Tabela 6: Zonat e Mbrojtura Mjedisore përgjatë bregdetit shqiptar

NR.	ZONA E MBROJTUR	KATEGORIA	SIP. SIPAS VENDIMIT TË SHPALLJES (NË HA)
1	Bunë-Velipojë	Peizazh i Mbrojtur (V)	2,302.7
2	Kompleksi lagunor Kune-Vain-Patok	Rezervat Natyror i Menaxhuar (IV)	9,393.90
3	Rrushkulli	Rezervat Natyror i Menaxhuar (IV)	650.00
4	Divjakë-Karavasta	Park Kombëtar (II)	22,389.08
5	Kompleksi ligatinor Vjosë-Nartë	Rezervat Natyror i Menaxhuar (IV)	21,238.00
6	Sazan-Karaburun	Park Kombëtar (II)	12,437.70
7	Karaburun	Rezervat Natyror i Menaxhuar (IV)	20,000.00
8	Llogara	Park Kombëtar (II)	1,769.20
9	Butrint	Park Kombëtar (II)	9,424.40
TOTAL			120,329.28

Në vitin 2019, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nisi një proces të rishikimit dhe rivlerësimit të zonave të mbrojtura në vend, i cili ka hasur në një debat mes shoqërisë civile, botës akademike dhe institucionit propozues.⁵⁸




Si pasojë e ri-vlerësimit dhe propozimeve të bëra nga AKZM përmes projekt VKM-ve të prezantuara për konsultim në 28 korrik 2021 (www.konsultimipublik.gov.al), zonat e mbrojtura

58 Vladimir Karaj. Mjedisoret në protest kundër rrudhjes së zonave të mbrojtura. BIRN, 20 maj 2021; <https://www.reporter.al/mjedisoret-ne-protete-kunder-rrudhjes-se-zonave-te-mbrojtura/>

59 Llogaritjet përpunuar nga ekspertët

përgjatë vijës bregdetare do të pësonin një tkurrje 13.495,8 ha, e cila e krahasuar me sipërfaqen e përgjithshme të zonave të mbrojtura është rreth 2.5%. Nga këto zona, sipas projekt vendimit të prezantuar nga MTM dhe AKZM, (shih Figurën 13) zonat më të prekura nga reduktimi janë ZM Llogara e cila reduktohet me 43.5%, ZM Vjosë-Nartë me 24%, ZM Bunë-Velipojë me 15,44% dhe ZM Kune-Vain-Patok e ZM Karaburun përkatësisht me 13.86% dhe 12.55%.



Pavarësisht se projekt-vendimet e Këshillit të Ministrave nuk janë aprovuar dhe janë në fazë konsultimi publik, është më rëndësi të theksojmë për interes të këtij studimi se presioni i urbanizimit të brezit bregdetar do të vazhdojë të jetë i madh dhe fatkeqësisht po orientohet në zonat e mbrojtura si të vetmet territore me potencial të lartë dhe akoma të paprekura, të cilat nga njëra anë mbartin një kapital natyror të lakmueshëm për investime infrastrukturore dhe nga ana tjetër duke qenë përgjithësisht prona publike, kostot e transferimit të pronësisë janë minimale. Një rast konkret ishte projekti i kompanisë Mabetex që përfshinte ndërtimin e mbi 2,300 apartamenteve, disa hoteleve, rreth 370 vilave si dhe objekte ndihmëse si një fushë golfi dhe pistë për ulje-ngritjen e helikopterëve, por që u kundërshtua fuqimisht nga një koalicion organizatash dhe shoqatash mjedisore, por jo vetëm.⁶¹

60 Llogaritjet përpunuar nga ekspertët.

61 EcoAlbania. Resorti i Mabetex kërcënon Parkun Kombëtar “Divjakë - Karavasta. 25.8.2017; www.ecoalbania.org

4. ANALIZIMI DHE PRIORITIZIMI I ÇËSHTJEVE MJEDISORE BREGDETARE

4.1 Qarku Vlorë

Riviera bregdetare e qarkut Vlorë që përfshin bashkinë Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol karakterizohet nga një metabolizëm urban me potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, bujqësor, turistik dhe industrial. Qarku prodhon 160,000 ton mbetje urbane në vit të cilat aktualisht grumbullohen në landfillin sanitar të Bajkaj për pjesën e Rivierës Sarandë, Konispol dhe Himarë. Ndërsa Bashkia Vlorë përfshirë dhe Orikumin, përdorin akoma një venddepozitim të vjetër dhe janë në ndërtim të landfillit të ri sanitar mbështetur nga kfW (Instituti për Kredi për Ndërtim).⁶² Nga totali i mbetjeve urbane në qarkun Vlorë, bashkia Vlorë prodhon 76.9% të mbetjeve (122,463 ton), Himara 5 % (7,950 ton në vit), Saranda 17.6% (28,000 ton në vit) dhe bashkia Konispol me 0.5% ose (800 ton në vit).⁶³




Fig. 14

Harta e rivierës në qarkun Vlorë. Burimi: Bashkia Vlorë & DeaStudio, 2016.

62 Ministria e Zhvillimit Urban. Vizioni dhe Strategjia Territoriale. Narrativë e përbashkët për të katërta Bashkitë. Shërbim konsulence për hartimin e planeve të përgjithëshme vendore. Dea Studio & Thymio Papayannis and Associates Inc.

63 Ministria e Zhvillimit Urban. Vizioni dhe Strategjia Territoriale. Narrativë e përbashkët për të katërta Bashkitë. Po aty. Fq.6.

4.1.1 Problematikat kryesore mjedisore në Qarkun e Vlorës

Nga puna hulumtuese e grupit të ekspertëve të angazhuar në hartimin e këtij raporti studimor por edhe duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara në workshopin tematik rajonal të zhvilluara nga EcoAlbania me aktorët e targetuar më 23 korrik 2021, në Qarkun e Vlorës dhe specifikisht përgjatë bregdetit janë evidentuar kryesisht këto problematika mjedisore:


Tabela 7: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuara në zonën bregdetare të Qarkut të Vlorës

NR.	PROBLEMTIKA MJEDISORE
1	Presioni i lartë në ekosistemin bregdetar për shkak të urbanizimit të lartë dhe zhvillimit të strukturave akomoduese të turizmit
2	Tkurrja e zonave të mbrojtura në rezervatin natyror të mbrojtur Vjosë-Nartë për ndërtimin e aeroportit dhe infrastrukturën mbështetëse të tij
3	Keqmenaxhimi i mbetjeve në plazhet e bregdetit
4	Ndotja potenciale detare nga aktiviteti portual dhe hidrokarburet në Vlorë. Prania e La Petrolifera Italo Albanese Sh. A. (ANP), e cila menaxhon një depo bregdetare për LPG (Gaz i Lëngshëm i Naftës), Naftë, derivatet e tij (Naftë, Benzinë, etj.) dhe mallra të tjerë, të lëngshëm dhe të ngurtë, në Gjirin e Vlorës si dhe së fundmi vendosja e TEC Vlorës në punë pas kalimit me gaz dhe impiantit të LNG me kompaninë Exxon Mobile
5	Ndotja potenciale nga aktiviteti portual - Porti i Sarandës
6	Ndotja detare nga fermtat e rritjes së peshkut në Karaburun, Porto Plaermo, Sarandë e Ksamil
7	Peshkimi i paligjshëm dhe shkatërrimi i biodiversitetit nënujor në Parkun Sazan-Karaburun
8	Tjetërsimi, shkatërrimi dhe fragmentimi i habitateve bregdetare (dunat ranore në Adriatik dhe bregu shkëmbor Sarandë-Ksamil)
9	Shpyllëzimi i pyllit të Sodës
10	Ndotja nga keqmenaxhimi i ujrave të ndotur dhe kanalizimeve urbane
11	Shfrytëzimi i paligjshëm i shtratit të lumenjve dhe erozioni i lartë bregdetar

4.1.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Vlorës

Në kuadër të këtij raporti studimor, ekipi i punës ka synuar të prioritarizojë problematikat mjedisore të evidentuara në zonën bregdetare të Qarkut të Vlorës. Procesi i prioritarizimit është mbështetur kryesisht në ballafaqimin mes gjetjeve të grupit të punës nga hulumtimi në zyrë duke përcaktuar 5 kategorite (clusters) kryesore të problematikave mjedisore dhe të dhënave të gjeneruara nga konsultimi me grupet e synuara të aktorëve të ndryshëm lokalë e rajonalë. Informacioni i aktorëve lokalë është gjeneruar përmes plotësimit të pyetësorit (Shih Shtojca A) në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë workshopeve si edhe nëpërmjet plotësimit të mëvonshëm përmes platformave online. Në Qarkun e Vlorës janë ftuar të marrin pjesë në workshop rreth 20 aktorë lokalë, përfaqësues institucionesh lokale e qendrore, përfaqësues të OSHC-ve dhe botës akademike të qarkut etj. Pyetësori është plotësuar në mënyrë direkte gjatë workshopeve ose në formën online nga 8 prej tyre; 5 gra dhe 3 burra.

Në grafikun më poshtë (Figura 15) paraqiten se cilat prej kategorive të problematikave mjedisore janë më prioritare sipas vlerësimit të aktorëve lokalë, të cilat kërkojnë një ndërhyrje më të ngutshme. Në këtë mënyrë, ndotja nga ujërat urbane dhe ujërat e ndotur vlerësohet të jetë prioriteti kryesor i vlerësuar kështu nga 23% të aktorëve, i pasuar nga problematika e konflikteve të zhvillimit bregdetar me 22% dhe ndotja portuale me 20%. Më pak prioritare është vlerësuar të jetë problematika e shkatërrimit të biodiversitetit përgjatë rivierës me 19% e pasuar nga erozioni detar dhe ndryshimet klimatike me vetëm 16%.



Megjithatë nëse do të vlerësohej secila prej kategorive në brendinë e tyre vihet re që diferencat e vlerësimit prioritar mes problematikave të secilës kategori janë shumë të vogla, ku të gjitha problematikat janë vlerësuar me prioritet mbi mesatar. Në figurën 16 paraqitet vlerësimi i aktorëve të Qarkut të Vlorës për problematikat mjedisore përgjatë bregdetit që kanë të bëjnë me ndotjen nga mbetjet urbane dhe ujërat e përdorura⁶⁴.

4.1.2.1 Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun e Vlorës

Për kategorinë “Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur” si problematika më të mëdha janë vlerësuar “menaxhimi joeficient i mbetjeve urbane” si dhe “mungesa e një landfilli sanitar në bregdet” me 3.63 pikë nga 4 në total. Problematike është vlerësuar edhe situata në deltat e lumenjve të Qarkut Vlorë, të cilët pasqyrojnë destinacionin e fundit të vendgrumbullimit të mbetjeve urbane të qarkut apo edhe të qarqeve fqinje. Situata në deltat lumore është vlerësuar mesatarisht me 3.38 pikë nga 4. Më pak problematike është vlerësuar situata e depozitimit të mbetjeve direkte në zonat bregdetare të Qarkut Vlorë me 3.25 pikë nga 4. Ndërkohë që problematikat e tjera që lidhen me menaxhimin e mbetjeve të ngurta janë vlerësuar si më pak të ngutshme për të ndërhyrë në gjetjen e një zgjidhjeje. Megjithatë fakti që të gjitha problematikat e evidentuara janë vlerësuar mesatarisht me më shumë se 3 pikë nga 4 maksimalisht, dëshmon që të gjitha mbeten sfida për t’u adresuar.

⁶⁴ Termi “ujërat e përdorur” përfshin ujërat që janë përdorur nga njeriu për përbushjen e funksioneve të tij urbane dhe përmbledh ujërat e zeza të taletëve, ato të lavamaneve, apo cative etj.

Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun e Vlorës



Fig. 16

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen nga mbetjet urbane në zonat bregdetare të Qarkut Vlorë

4.1.2.2 Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Vlorës

Duke i'u referuar Figurës 17 më poshtë, për kategorinë “Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Vlorës” si problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar “përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtimi” i cili është vlerësuar me 3.5 pikë nga 4. Shkaktarë të rritjes së erozionit bregdetar janë vlerësuar edhe “shkatërrimi i mbulesës bimore” dhe “mungesa e një rrjeti të përshtatshëm të kanalizimeve” të cilat mund të konsiderohen si masa adaptuese ndaj kontrollit të erozionit bregdetar. Këta faktorë janë vlerësuar mesatarisht me 3.25 pikë nga 4.

Jo më pak të rëndësishme në problematikat që ndikojnë në erozionin bregdetar janë vlerësuar edhe “ndërhyrjet inxhinierike në shtretërit e lumenjve” si diga, argjinatura etj. që pengonjë transportin e aluvioneve⁶⁵ drejt bregdetit, të cilat janë vlerësuar me 3 pikë nga 4. Në shkaqet e rritjes së erozionit bregdetar, “ndryshimet klimatike” janë vlerësuar si jo të rëndësishme nga aktorët e Qarkut të Vlorës të cilët e kanë vlerësuar mesatarisht me 1.75 pikë nga 4 maksimale.

Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Vlorës





Fig. 17

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Vlorës

⁶⁵ Materialet lymore, inerte (sedimentet) e imta që transportohen nga rrjedhat e lumenjve dhe që depozitohen ne4 rrjedhat e tyre të poshtëme.


4.1.2.3 Ndotja detare dhe portuale në Qarkun e Vlorës

Në Figurën 18 më poshtë paraqitet vlerësimi i problematikës mjedisore që ka të bëjë me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Vlorës. Sipas vlerësimit të aktorëve lokalë në Qarkun e Vlorës, më problematike në këtë kontekst gjykohet të jetë transferimi i ndotjes nga kontinenti në ujërat detare, i cili vlerësohet me 3.63 pikë nga 4. Kjo lidhet me shkarkimin në det të ujërave të patrajtuara nëpërmjet kanaleve e përrrenjve. Gjithashtu efektet e ndotjes së ujërave detare nga aktiviteti portual si dhe nga hidrokarburet vlerësohet me 3 nga 4 pikë maksimale.



4.1.2.4 Shkatërrimi i biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Vlorës

Një tjetër kategori e e problematikave mjedisore në zonat bregdetare të Qarkut të Vlorës, e analizuar në kuadër të këtij raporti studimor është edhe shkatërrimi i biodiversitetit. Në Figurën 19 paraqitet vlerësimi i problematikave që lidhen më këtë kategori.




Ndër faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në zonën e bregdetit në Qarkun e Vlorës, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë janë mbipeshkimi i vlerësuar mesatarisht me 3.63 pikë nga 4; përdorimi i mjeteve të gabuara për gjueti, i vlerësuar me 3.5 pikë nga 4 dhe fragmentimi e tjetërsimi i habitateve i vlerësuar me 3.38 pikë nga 4. Faktorë të tjerë si gjuetia e peshkimi i paligjshëm dhe ndotja nga akuakultura konsiderohen gjithashtu faktorë e fenomene problematike që ndikojnë në mënyrë të qenësishme në humbjen dhe shkatërrimin e biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Vlorës.

4.1.2.5 Sfidat e zhvillimit bregdetar në Qarkun e Vlorës

Një tjetër kategori (klaster) e problematikave mjedisore e marrë në analizë në këtë raport është edhe konflikti i zhvillimit në zonat bregdetare. Analiza e këtyre konflikteve ka të bëjë me zhvillimin e hapësirave përgjatë bregdetit në funksion të zhvillimit ekonomik. Shpeshherë ky zhvillim vendos në presion zonat natyrore ose gjysmë-natyrore, zonat e mbrojtura si edhe komponentin social ku më të riskuarat janë shtresat e marginalizuara të shoqërisë. Në këtë kuadër sa i përket kësaj kategorie në Qarkun e Vlorës, zhvillimi urban si dhe zgjerimi i zonave urbane paraqitet si një problem mjaft i mprehtë, i cili vlerësohet nga aktorët lokalë me 4 pikë nga 4.

Jo pak të qenësishme vlerësohen të jenë edhe problematikat e zhvillimit që kanë të bëjnë me ndërtimin e strukturave akomoduese të turizmit masiv si hotele, resorte etj., apo edhe projektet infrastrukturore si aeroportet dhe autostradat të cilat zhvillohen ose janë planifikuar të zhvillohen duke gjeneruar konflikte mjedisore që konsistojnë në uljen e cilësisë së mjedisit.



4.2 Qarku Durrës

Qarku i Durrësit është një territor i larmishëm i përbërë nga bashkitë e Durrësit, Krullës dhe Shijakut. Edhe pse aktualisht është një ndër bashkitë potenciale për sa i përket zhvillimit ekonomik falë zhvillimit të sektorit të turizmit, Durrësi gjatë 10-15 viteve të fundit ka treguar

humbje të mëdha në terma të hapësirave publike dhe duke i lënë hapësirë procesit të betonizimit duke rritur kështu mundësinë e përmbytjeve më të shpeshta gjithashtu të ndikuara nga efektet e ndryshimit të klimës. Një shqetësim tjetër është i lidhur me ndotjen e zonave bregdetare që vijnë si rezultat i mungesës së kanalizimeve nëntokësore dhe menaxhimi i mbetjeve urbane, duke marrë parasysh kryesisht periudhën e sezonit të verës. Në fakt, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura ka çuar indirekt (përmes lumenjve) që ato të derdhen në det. Lumenjtë Erzen dhe Ishëm derdhen në territorin e bashkisë së Durrësit, e cila sipas Raportit të Gjendjes së Mjedisit 2020 (RGJM)⁶⁶ janë ndër lumenjtë më të ndotur në vend. Prandaj, kalimi i lumit Erzen përgjatë territorit të bashkisë Shijak dhe gjendja e tij e dobët nga mbetjet urbane dhe nxjerrja e pakontrolluar e agregateve ka degraduar ndjeshëm tokat bujqësore duke ndikuar kështu në produktivitetin e tyre.



Fig. 21

Harta e Qarkut Durrës. Burimi: Shtetiweb

66 AKM. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2020. Tiranë. Aksesuar 12 korrik 2021; www.akm.gov.al

4.2.1 Problematikat kryesore mjedisore në Qarkun e Durrësit

Nga puna hulumtuese e grupit të ekspertëve të angazhuar në hartimin e këtij raporti studimor por edhe duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara në workshopin tematik rajonal të zhvilluar nga EcoAlbania me aktoret e targetuar më 22 korrik 2021, në Qarkun e Durrësit e specifikisht përgjatë bregdetit janë evidentuar kryesisht këto problematika mjedisore:

Tabela 8: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuar në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit

NR.	PROBLEMATIKA MJEDISORE
1	Ndotja potenciale nga aktiviteti portual - Porti i Durrësit
2	Erozioni kodrinor në Spille
3	Ndotje landfill i Porto Romanos
4	Ndotje kimike Porto Romano
5	Ndotje potenciale nga aktiviteti i hidrokarbureve në Porto - Romano
6	Mungesa e rrjetit të ujërave të zeza në Njësitë Administrative Ishëm, Rrushkull
7	Sipërfaqe e rrezikuar nga përmbytjet e Lumit Erzen dhe grumbullimi i mbetjeve urbane nga Sukthi, katund i Ri, Rrushkull drejt detit
8	Ndotje detare nga prurjet e lumit Erzen
9	Landfilli i mbetjeve në Manëz
10	Mungesa e rrjetit inxhinierik të ujërave të zeza në Lalëz
11	Ndotje detare nga prurjet e Lumit Ishëm
12	Shkatërimi i habitateve të dunave ranore dhe fragmentimi i habitateve kodrinore


4.2.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Durrësit

Ashtu si edhe në Qarkun e Vlorës, studimi ka prioritarizuar problematikat mjedisore të evidentuara në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit. Procesi i prioritarizimit është mbështetur kryesisht në ballafaqimin mes gjetjeve të grupit të punës nga hulumtimi në zyrë dhe të dhënave të gjeneruara nga konsultimi me grupet e synuara të aktorëve të ndryshëm lokalë e rajonalë.

Në Qarkun e Durrësit janë ftuar të marrin pjesë në workshop rreth 40 aktorë lokalë, përfaqësues institucionesh lokale e qendrore, përfaqësues të OSHC-ve, botës akademike të qarkut etj. Pyetësori është plotësuar në mënyrë direkte gjatë workshopeve dhe në formën online nga 16 prej tyre, 12 gra dhe 4 burra.

Në grafikun më poshtë (Figura 22) paraqiten se cilat prej kategorive të problematikave mjedisore janë më prioritare sipas vlerësimit të aktorëve lokalë.

Në këtë mënyrë, ndotja nga ujërat urbane dhe ujërat e ndotur vlerësohet të jetë prioriteti kryesor i vlerësuar kështu nga 24% të aktorëve, i pasuar nga problematika e ndotjes portuale dhe detare me 21%. Evidente është edhe problematika e shkatërrimit të biodiversitetit përgjatë rivierës me e vlerësuar me 20%. Ndërkohë që për Qarkun e Durrësit më pak prioritare janë vlerësuar kategoritë e problematikave që kanë të bëjnë me konfliktet e zhvillimit bregdetar të vlerësuara me 18% e pasuar nga erozioni detar dhe ndryshimet klimatike me vetëm 17%.



Ndërkohë që nga analiza specifike e secilës prej kategorive, ashtu si edhe në Qarkun e Vlorës vihet re që diferencat e vlerësimit prioritar mes problematikave të secilës kategori janë shumë të vogla ku të gjitha problematikat janë vlerësuar me prioritet mbi mesatar. Në figurën 23 paraqitet vlerësimi i aktorëve të Qarkut të Durrës për problematikat mjedisore përgjatë bregdetit që kanë të bëjnë me ndotjen nga mbetjet urbane dhe ujërat e përdorur.


4.2.2.1 Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun e Durrësit

Për katëgorinë “Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur” si problematika më të mëdha janë vlerësuar “menaxhimi joeficient i mbetjeve urbane” si dhe “shkarkimet industriale të industrisë së peshkimit” me nga 3.75 pikë secila nga 4 në total. Problematike është vlerësuar gjithashtu edhe situata e depozitimit të mbetjeve direkt në zonat bregdetare të Qarkut Durrës, pa kushte sanitare dhe mjedisore me 3.63 pikë nga 4.

Depozitimi i mbetjeve urbane në zona që nuk plotësojnë standardet mjedisore dhe janë të vendosura në vende të papërshtatshme dhe të paplanifikuara bregdetare si dhe mungesa

e një landfilli sanitar në bregdet bën që mbetjet të depozitohen në vendgrumbullime afër lumenjve. Pikërisht këto problematika janë vlerësuar mesatarisht me 3.56 pikë nga 4 nga aktorët lokalë të Qarkut të Durrësit.

Mungesa e impiantit të trajtimit të ujërave të përdorur ose mos shtrirja e funksionit të tij në të gjithë hapësirën e zonave bregdetare të Qarkut Durrës është vlerësuar gjithashtu si një problematikë mjedisore e cila është vlerësuar me 3.44 nga 4 pikë në total. Megjithatë fakti që të gjitha problematikat e evidentuara janë vlerësuar mesatarisht me më shumë se 3 pikë nga 4 maksimalisht, dëshmon që të gjitha mbeten sfida për t'u adresuar.



4.2.2.2 Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Durrësit

Në figurën 24 më poshtë, për kategorinë “Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Durrësit” si problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar “shkatërrimi i mbulesës bimore” i cili është vlerësuar me 3.69 pikë nga 4. Faktori tjetër që ka një ndikim domethënës në rritjen e nivelit të erozionit bregdetar në Qarkun e Durrësit sipas vlerësimit është edhe efekti i “ndryshimeve klimatike”, i cili vlerësohet me 3.56 pikë nga 4. Shkaktarë të tjerë të rritjes së erozionit bregdetar janë vlerësuar të jenë edhe “përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtimi” dhe “mungesa e një rrjeti të përshtatshëm të kanalizimeve” të cilat janë vlerësuar me 3.5 pikë nga 4.

Më pak të rëndësishme në problematikat që ndikojnë në erozionin bregdetar janë vlerësuar edhe “ndërhyrjet inxhinierike në shtretërit e lumenjve” si diga, argjinatura etj. që pengonjë transportin e aluvioneve drejt bregdetit, të cilat janë vlerësuar me 3.25 pikë nga 4.

Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Durrësit




Fig. 24

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Durrësit

4.2.2.3 Ndotja detare dhe portuale në Qarkun e Durrësit

Në figurën 25 më poshtë paraqitet vlerësimi i problematikës mjedisore që ka të bëjë me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Durrësit. Sipas vlerësimit të aktorëve lokal në këtë Qark, më problematike në këtë kontekst gjykohet të jetë transferimi i ndotjes nga kontinenti në ujërat detare si dhe ndotja nga hidrokarburet të cilët vlerësohen me 3.63 nga 4 pikë maksimale. Disi më pak problematike paraqitet ndotja e shkaktuar nga aktiviteti portual në portin e Durrësit, i cili vlerësohet me 3.5 pikë nga 4.

Ndotja detare dhe portuale në Qarkun e Durrësit





Fig. 25

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Durrësit

4.2.2.4 Shkatërrimi i biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit

Një tjetër kategori e problematikave mjedisore në zonat bregdetare të Qarkut të Durrësit

është edhe shkatërrimi i biodiversitetit. Në Figurën 26 paraqitet vlerësimi i problematikave që lidhen me këtë kategori.




Ndër faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në zonën e bregdetit në Qarkun e Durrësit, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë janë mbipeshkimi dhe fragmentimi e tjetërsimi i habitateve i vlerësuar me 3.25 pikë nga 4. Faktorë të tjerë si ndotja nga akuakultura dhe peshkimi i paligjshëm konsiderohen gjithashtu faktorë e fenomene problematike që ndikojnë në mënyrë të qenësishme në humbjen dhe shkatërrimin e biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit të cilat janë vlerësuar me nga 3 pikë nga 4. Gjuetia e paligjshme dhe përdorimi i mjeteve të gabuara për gjueti janë vlerësuar respektivisht me 2.69 dhe 2.81 pikë nga 4.

4.2.2.5 Sfidat e zhvillimit bregdetare në Qarkun e Durrësit

Kategoria (klaster) i fundit i problematikave mjedisore e marrë në analizë në këtë raport është edhe konflikti i zhvillimit në zonat bregdetare. Në këtë kuadër sa i përket kësaj kategorie në Qarkun e Durrësit, zhvillimi urban si dhe zgjerimi i zonave urbane ashtu si edhe në Qarkun e Vlorës paraqitet si një problem mjaft i mprehtë, i cili vlerësohet nga aktorët lokalë me 3.88 pikë nga 4.

Jo pak të qenësishme vlerësohen të jenë edhe problematikat e zhvillimit që kanë të bëjnë me ndërtimin e strukturave akomoduese të turizmit masiv si hotele, resorte etj. edhe pse tashmë Durrësi mund të konsiderohet si zonë që e ka ezauruar fazën e ndërtimeve intensive. Më pak të vlerësuara si problematike janë projektet infrastrukturore si aeroportet, autostradat etj. të cilat janë vlerësuar me 3.31 pikë nga 4.



4.3 Qarku Lezhë

Qarku i Lezhës përfshin bashkitë e Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit. Lezha është një nga qendrat më të rëndësishme të territorit veri-perëndimor të Shqipërisë në disa aspekte, ku monumentet malore, fushore, pyjore, arkeologjike dhe historike, laguna dhe deti formojnë një komunitet të spikatur. Territori është i ndërthurur dhe është pjesë e kësaj zone, ku të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe florës janë mjaft të larmishme. Në këtë territor, bashkëjetojnë një shumëllojshmëri ekosistemesh, të tilla si lumenj, vijë detare, bregdetare, gjelbërim të përhershëm dhe gjetherënës dhe të përziera pyje halore, livadhe dhe kullota.

Zona kryesore ku efektet e ndryshimit të klimës kanë filluar të ndjehen qëndron në Deltën e Lumit Drin dhe Mat (DLDM) dhe është identifikuar si një rajon i prekshëm kritik për ndryshueshmërinë e klimës dhe efektet e tij të pritshme. Rritja e presionit njerëzor ka çuar në ndryshime të konsiderueshme në mjedisin e zonës së DLDM.⁶⁷

Në të gjithë zonën e DLDM, rritja e shpejtë e popullsisë po modifikon mjedisin natyror përmes përdorimit të tepërt të burimeve bregdetare, detare dhe grykëderdhjes me pasojë të pakthyeshme si: humbja e habitateve bregdetare, detare dhe grykëderdhëse; zhdukja e veçorive të rëndësishme gjeomorfologjike (dunat e rërës); humbje të konsiderueshme të bimësisë bregdetare, florës dhe faunës; zhdukja e zonës buferike⁶⁸; ndryshimi në shpërndarjen e specieve aliene (pushtuese); reduktimi i kapacitetit rigjenerues të ekosistemeve duke rritur nivelet e detit dhe ndryshimin e klimës; depërtimi i ujit të kripur. Degradimi që rezulton ka një numër pasojash që kufizojnë të dyja mundësitë ekzistuese dhe

⁶⁷ Silvija Nora Kalnins . Identification and Implementation of the Adaptation Response Measures in the Drini-Mati River Deltas (PIMS 3629). UNDP, Tirana 2013

⁶⁸ Zonë periferike përreth zones qendrore që ka si funksion zbutjen e ndikimit dhe presionit të shkaktuar nga aktiviteti njerëzor në një zonë të mbrojtur

të ardhshme për përdorimin njerëzor të zonës, të tilla si: erozioni dhe fundosja e zonave të ulta nga ngritja e nivelit të detit dhe ngritja e frekuencave të stuhisë, duke çuar në humbjen e hapësirës; ndryshimi i regjimit hidrologjik, duke çuar në humbjen e ujit të ëmbël për bujqësinë, industrinë e tjera dhe për përdorim shtëpiak; humbja e zonës së ligatinës, duke çuar në zvogëlimin e mundësisë për mbrojtje nga ngritja e niveleve të detit, humbje të vlerave tërheqëse të ekosistemeve dhe shërbimeve të tyre; habitatit dhe ndryshimi i biodiversitetit duke çuar në humbja e burimeve dhe rinovimi mjedisor.



Fig. 28

Harta e qarkut Lezhë. Burimi: ShtetWeb.

4.3.1 Problematika kryesore mjedisore në Qarkun e Lezhës

Nga puna hulumtuese e grupit të ekspertëve të angazhuar në hartimin e këtij raporti studimor por edhe duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara në workshopin tematik rajonal

të zhvilluara nga EcoAlbania me aktoret e targetuar më 21 korrik 2021, në Qarkun e Lezhës e specifikisht përgjatë bregdetit janë evidentuar kryesisht këto problematika mjedisore:

Tabela 9: Paraqitja e problematikave më të mprehta mjedisore të identifikuara në zonën bregdetare të Qarkut të Lezhës

NR.	PROBLEMATIKA MJEDISORE
1	Gjueti dhe peshkim i paligjshëm në Kune-Vain, Tale dhe Patok
2	Erozioni detar në Lagunën Kune-Vain
3	Ndotja portuale në Shëngjin
4	Mbetjet urbane të akumuluar në grykëderdhjen e Lumit Drin deri në Lumin Mat
5	Shkarkime industriale të industrisë së peshkimit
6	Hedhja e mbetjeve urbane në Drinin e Lezhës
7	Rritja e specieve invazive si Gaforja Blu në lagunë dhe shkatërimi i ekosistemit të Lagunës
8	Humbja e habitateve bregdetare, detare dhe grykëderdhëse
9	Zhdukja e veçorive të rëndësishme gjeomorfologjike (dunat e rërës)
10	Ndryshimi në shpërndarjen e specieve aliene (pushtuese)
11	Ndryshimi i regjimit hidrologjik, duke çuar në humbjen e ujit të ëmbël për bujqësinë, industrinë e tjera dhe për përdorim shtëpiak

4.3.2 Prioritizimi i problematikave mjedisore në Qarkun e Lezhës


Ashtu si edhe në dy qarqet e tjera, studimi ka prioritarizuar problematikat mjedisore të evidentuara në zonën bregdetare të Qarkut të Lezhës. Procesi i prioritarizimit ka ndjekur të njëjtën linjë të ballafaqimit mes gjetjeve të grupit të punës nga hulumtimi në zyrë dhe të dhënave të gjeneruara nga konsultimi me grupet e synuara të aktorëve të ndryshëm lokalë e rajonalë.

Në Qarkun e Lezhës janë ftuar të marrin pjesë në workshop rreth 30 aktorë lokalë, përfaqësues institucionesh lokale e qendrore, përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësi është plotësuar në mënyrë direkte gjatë workshopeve nga 6 prej tyre; 2 gra dhe 4 burra.

Në grafikun më poshtë (Figura 29) paraqiten se cilat prej kategorive të problematikave mjedisore janë më prioritare sipas vlerësimit të aktorëve lokal. Në këtë mënyrë, ndotja nga ujërat urbane dhe ujërat e ndotur vlerësohet të jetë prioriteti kryesor i vlerësuar nga 24% e aktorëve, i ndjekur nga problematika e konflikteve të zhvillimit bregdetar me 23%.

Evidente është edhe problematika e erozionit detar dhe ndryshimet klimatike të vlerësuar me

20% dhe ajo e shkatërrimit të biodiversitetit përgjatë rivierës e vlerësuar me 19%. Më pak prioritare është vlerësuar problematika e ndotjes portuale dhe detare me vetëm 14%. Ndërkohë që nga analiza specifike e secilës prej kategorive, ashtu si edhe në Qarkun e Vlorës vihet re që diferencat e vlerësimit prioritar mes problematikave të secilës kategori janë shumë të vogla, ku të gjitha problematikat janë vlerësuar me prioritet mbi mesatar. Në figurën 30 paraqitet vlerësimi i aktorëve të Qarkut të Lezhës për problematikat mjedisore përgjatë bregdetit që kanë të bëjnë me ndotjen nga mbetjet urbane dhe ujërat e përdorur.



4.3.2.1 Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun e Lezhës

Për kategorinë “Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur” si problematika më të mëdha të cilat janë vlerësuar me nga 3.83 pikë nga 4 janë: depozitimi i mbetjeve urbane në zona që nuk plotësojnë standardet mjedisore dhe janë të vendosura në vende të papërshtatshme dhe të paplanifikuara bregdetare; depozitimi i mbetjeve të ngurta pranë deltave lumore kanë bërë që ato të shihen si emergjencia mjedisore; menaxhimi joefiçient i mbetjeve urbane si dhe problematika e depozitimit të mbetjeve direkt në zonat bregdetare të Qarkut të Lezhës.

Mungesa e një landfilli sanitar në bregdet si dhe mungesa e impiantit të trajtimit të ujërave të përdorur ose mos shtrirja e funksionit të tij në të gjithë hapësirën e zonave bregdetare të Qarkut Lezhë, janë vlerësuar gjithashtu si një problematikë mjedisore me 3.67 nga 4 pikë në total. Më pak problematike paraqitet situata e lidhur me shkarkimet industriale të industrisë së peshkimit e cila është vlerësuar me 3.5 pikë secila nga 4 në total.

Megjithatë ashtu si edhe në rajonet e tjera ndotja urbane e bregdetit është vlerësuar mesatarisht me më shumë se 3 pikë nga 4 maksimalisht, çka dëshmon që të gjitha problematikat e analizuar nën këtë kategori mbeten sfida për t’u adresuar.

Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun e Lezhës




Fig. 30

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen nga mbetjet urbane në zonat bregdetare të Qarkut Lezhë

4.3.2.2 Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Lezhës

Në figurën 31 më poshtë, për kategorinë “Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Lezhës” si problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar “përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtimi” i cili është vlerësuar me 4 pikë nga 4. Pas tij renditet “shkatërrimi i mbulesës bimore” me 3.83 pikë nga 4 në total.

Faktori tjetër që ka një ndikim sinjifikativ në rritjen e nivelit të erozionit bregdetar në Qarkun e Lezhës sipas vlerësimit janë edhe “ndërhyrjet inxhinierike në shtretërit e lumenjve” si diga, argjinatura etj., që pengojnë transportin e aluvioneve drejt bregdetit, të cilat janë vlerësuar me 3,65 pikë nga 4.

Ndërkohë që më pak të rëndësishme në problematikat që ndikojnë në erozionin bregdetar janë vlerësuar efekti i “ndryshimeve klimatike” dhe “mungesa e një rrjeti të përshtatshëm të kanalizimeve” të cilat janë vlerësuar me nga 3.5 pikë nga 4.

Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Lezhës




Fig. 31

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me erozionin detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun e Lezhës

4.3.2.3 Ndotja detare dhe portuale në Qarkun e Lezhës

Në figurën 32 më poshtë paraqitet vlerësimi i problematikës mjedisore që ka të bëjë me ndotjen detare dhe portuale ne Qarkun e Lezhës. Sipas vlerësimit të aktorëve lokal në këtë Qark, më problematike në këtë kontekst vlerësohet të jetë transferimi i ndotjes nga kontinenti në ujërat detare, i cili është vlerësuar me 3.5 nga 4 pikë. Pas tij renditet aktiviteti portual në portin e Shëngjinit, i cili vlerësohet me 3.17 pikë nga 4. Disi më pak problematike paraqitet ndotja e shkaktuar nga hidrokarburet të cilët vlerësohen me 3 nga 4 pikë maksimale.




Fig. 32

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me ndotjen detare dhe portuale në Qarkun e Lezhës

4.3.2.4 Shkatërrimi i biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Lezhës

Shkatërrimi i biodiversitetit në zonat bregdetare të Qarkut të Lezhës është një tjetër kategori e problematikave mjedisore e analizuar. Në Figurën 33 paraqitet vlerësimi i problematikave që lidhen me këtë kategori.




Fig. 33

Vlerësimi i problematikave mjedisore që lidhen me shkatërrimin e biodiversitetit në Qarkun e Lezhës


Ndër faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në zonën e bregdetit në Qarkun e Lezhës, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë janë ndotja nga akuakultura e vlerësuar me 3.5 pikë nga 4, e ndjekur nga peshkimi i paligjshëm dhe gjuetia e paligjshme të vlerësuar me 3.33 pikë nga 4. Faktorë të tjerë që konsiderohen gjithashtu faktorë e fenomene problematike që ndikojnë në mënyrë të qenësishme në humbjen dhe shkatërrimin e biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Lezhës të cilat janë vlerësuar me nga 3 pikë nga 4 janë fragmentimi e tjetërsimi i habitateve, përdorimi i mjeteve të gabuara për gjueti dhe mbipeshkimi.

4.3.2.5 Sfidat e zhvillimit bregdetar në Qarkun e Lezhës

Kategoria (klaster) e fundit e problematikave mjedisore e marrë në analizë në këtë raport është edhe konflikti i zhvillimit në zonat bregdetare.

Në këtë kuadër sa i përket kësaj kategorie në Qarkun e Lezhës, zhvillimi i projekteve infrastrukturore si aeroportet dhe autostradat janë vlerësuar si më problematike duke marrë vlerësimin mesatar prej 3.67 pikësh nga 4. Jo pak të qenësishme vlerësohen të jenë edhe problematikat e zhvillimit që kanë të bëjnë me ndërtimin e strukturave akomoduese të turizmit masiv si hotele, resorte etj., të cilët vlerësohen më 3.5 pikë në këtë studim.

Zhvillimi urban si dhe zgjerimi i zonave urbane në ndryshim nga qarqet e tjera paraqitet si një problem jo edhe aq i madh megjithëse zona e Shëngjinit tashmë është zgjeruar duke u shndërruar në një hapësirë urbane që mbështet turizmin masiv bregdetar. Kjo problematikë është vlerësuar me 2.33 pikë nga 4.



5. PËRFUNDIME

5.1 Qarku Vlorë

Në këtë studim u theksuan problematikat kryesore mjedisore në tre zona kryesore të vijës bregdetare të Shqipërisë, siç janë qarku Lezhë, Durrës dhe Vlorë duke përfshirë 6 bashki bregdetare Konispol, Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës dhe Lezhë.

Studimi ka marrë në konsideratë prezantimin jo vetëm të problematikave mjedisore por të trajtojë dhe zonat e rrezikuara nga ndotja mjedisore që e kanë burimin më thellë në territor siç janë lumenjtë apo industria ndotëse në territor.

Raporti i Portofolit mjedisor në zonat bregdetare u fokusua në pesë (5) kategori kryesore; **i) Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur; ii) Sfidat e zhvillimit bregdetar; iii) Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike; iv) Ndotja detare dhe portuale dhe v) Shkatërrimi i biodiversitetit të rivierës.** Brenda këtyre kategorive studimi ka evidentuar rreth 30 probleme mjedisore që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe monitorim nga autoritete publike. Gjithashtu thekson nevojën për një dialog institucional mes pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij vendor në Shqipëri. Në studim, gjitha problematikat e evidentuara janë prioritetuar në bazë të rëndësisë së tyre, sipas ndarjes në nivel qarku dhe sipas pikëzimit të realizuar nga aktorët e konsultuar.

A. Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur

1. Në Qarkun e Vlorës, ndotja **nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur** është prioriteti kryesor ku 23% e të anketuarve e renditën me pikë më të larta. Ndërsa, **sfidat e zhvillimit bregdetar** u vlerësua me 22% të anketuarve çka përbën dhe prioritetin dytësor për ta. Në veçanti, mungesa e një landfilli në bregdet dhe mungesa e riciklimit është vlerësuar si problematika kryesore me 3.63 pikë nga 4 të mundshme.

2. Në Qarkun e Durrësit, **ndotja nga ujërat urbane dhe ujërat e ndotur** vlerësohet të jetë prioriteti kryesor i vlerësuar nga 24% të aktorëve, i pasuar nga problematika e ndotjes portuale dhe detare me 21%. Evidente është edhe problematika e **shkatërrimit të biodiversitetit** përgjatë rivierës me e vlerësuar me 20%. Ndërkohë më pak prioritare janë vlerësuar kategoritë e problematikave që kanë të bëjnë me sfidat e zhvillimit bregdetar të vlerësuar me 18% e pasuar nga erozioni detar dhe ndryshimet klimatike me vetëm 17%.

3. Në Qarkun e Lezhës, **ndotja nga ujërat urbane dhe ujërat e ndotur** vlerësohet të jetë prioriteti kryesor i vlerësuar nga 24% e aktorëve, i ndjekur nga problematika e sfidave të zhvillimit bregdetar me 23%. Evidente është edhe problematika e **erozionit detar** dhe ndryshimet klimatike të vlerësuar me 20% dhe ajo e **shkatërrimit të biodiversitetit** përgjatë rivierës e vlerësuar me 19%. Më pak prioritare është vlerësuar problematika e ndotjes portuale dhe detare me vetëm 14%.

B. Sfidat e zhvillimit bregdetar

1. Në këtë kategori ekspertët analizuan dy tregues kryesor: i) intensitetin e ndërtimeve dhe ii) pakësimin e zonave të mbrojtura në bregdet. Një gjetje me rëndësi është adresimi i problemit të presionit të lartë për ndërtime ndaj zonave të mbrojtura që shtrihen përgjatë vijës bregdetare. Analiza e ekspertëve nxori në pah se vetëm në 3 qarqet në studim, synohet tkurrja me 2.5% e zonës së mbrojtur ose (13,495.8 ha).
2. Duke analizuar planet vendore të zhvillimit për bashkitë Himarë, Vlorë, Sarandë, Konispol dhe Lezhë (**Durrësi akoma nuk e ka miratuar planin e zhvillimit**) ekspertët vërejtën se të gjitha bashkitë kanë propozuar rritje të urbanizimit ku kryeson Lezha me 807 ha. Sipas planeve të përgjithshme vendore në total hapësira e propozuar për urbanizmin në bashkitë Himarë, Vlorë, Sarandë, Konispol dhe Lezhë shkon në 1,895 ha.
3. Bashkia Vlorë ka një rritje prej 10.9% të intensitetit të urbanizimit sipas planit të zhvillimit vendor dhe është duke rishikuar sërish PVZH - që të akomodojë kërkesat në rritje për urbanizim.
4. Në Qarkun e Durrësit, zhvillimi urban si dhe zgjerimi i zonave urbane ashtu si edhe në Qarkun e Vlorës paraqitet si një problem mjaft i mprehtë, i cili vlerësohet nga aktorët lokalë me 3.88 pikë nga 4 pikë.
5. Në Qarkun e Lezhës, zhvillimi i projekteve infrastrukturore si aeroportet dhe autostradat janë vlerësuar si më problematike duke marrë vlerësimin mesatar prej 3.67 pikësh nga 4. Jo pak të qenësishme vlerësohen të jenë edhe problematikat e zhvillimit që kanë të bëjnë me ndërtimin e strukturave akomoduese të turizmit masiv si hotele, resorte etj., të cilët vlerësohen më 3.5 pikë në këtë studim.

C. Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike

1. Në Qarkun Vlorë, problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar “përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtimi” i cili është vlerësuar me 3.5 pikë nga 4. Por shkaktarë të rritjes së erozionit bregdetar janë vlerësuar edhe “shkatërrimi i mbulesës bimore” dhe “mungesa e një rrjeti të përshtatshëm të kanalizimeve” të cilat mund të konsiderohen si masa adaptuese ndaj kontrollit të erozionit bregdetar. Këta faktorë janë vlerësuar mesatarisht me 3.25 pikë nga 4.
2. Në Qarkun e Durrësit, si problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar **“shkatërrimi i mbulesës bimore”** i cili është vlerësuar me 3.69 pikë nga 4. Faktori tjetër që ka një ndikim domethënës në rritjen e nivelit të erozionit bregdetar në Qarkun e Durrësit sipas vlerësimit është edhe efekti i **“ndryshimeve klimatike”**, i cili vlerësohet me 3.56 pikë nga 4.

3. Në Qarkun e Lezhës, problematika më të mëdha të cilat rezultojnë në rritjen e erozionit bregdetar është vlerësuar **“përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtimi”** i cili është vlerësuar me 4 pikë nga 4.
4. Pas tij renditet **“shkatërrimi i mbulesës bimore”** me 3.83 pikë nga 4 në total.

D. Ndotja detare dhe portuale

1. Në Qarkun e Vlorës, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë, më problematike gjykohet të jetë **transferimi i ndotjes nga kontinenti** në ujërat detare, i cili vlerësohet me 3.63 pikë nga 4. Kjo lidhet me shkarkimin në det të ujërave të patrajtuara nëpërmjet kanaleve e përrenjve. Gjithashtu efektet e ndotjes së ujërave detare nga **aktiviteti portual** si dhe nga **hidrokarburet** vlerësohet me 3 nga 4 pikë maksimale.
2. Në Qarkun e Durrësit, më problematike gjykohet të jetë transferimi i ndotjes nga kontinenti në ujërat detare si dhe ndotja nga hidrokarburet të cilët vlerësohen me 3.63 nga 4 pikë maksimale. Disi më pak problematike paraqitet ndotja e shkaktuar nga aktiviteti portual në portin e Durrësit, i cili vlerësohet me 3.5 pikë nga 4.
3. Në Qarkun e Lezhës, sipas vlerësimit të aktorëve, më problematike vlerësohet të jetë transferimi i ndotjes nga kontinenti në ujërat detare, i cili është vlerësuar me 3.5 nga 4 pikë. Pas tij renditet aktiviteti portual në portin e Shëngjinit, i cili vlerësohet me 3.17 pikë nga 4. Disi më pak problematike paraqitet ndotja e shkaktuar nga hidrokarburet të cilët vlerësohen me 3 nga 4 pikë maksimale.

E. Shkatërrimi i biodiversitetit të rivierës

1. Ndër faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në zonën e bregdetit në Qarkun e Vlorës, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë janë mbipeshkimi i vlerësuar mesatarisht me 3.63 pikë nga 4; **përdorimi i mjeteve të gabuara për gjueti**, i vlerësuar me 3.5 pikë nga 4 dhe **fragmentimi e tjetërsimi i habitateve** i vlerësuar me 3.38 pikë nga 4.
2. Në Qarkun e Durrësit, ndër faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në zonën e bregdetit, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë janë **mbipeshkimi** dhe **fragmentimi e tjetërsimi i habitateve** i vlerësuar me 3.25 pikë nga 4. Faktorë të tjerë si ndotja nga akuakultura dhe peshkimi i paligjshëm konsiderohen gjithashtu faktorë e fenomene problematike që ndikojnë në mënyrë të qenësishme në humbjen dhe shkatërrimin e biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut të Durrësit të cilat janë vlerësuar me nga 3 pikë nga 4.
3. Në Qarkun e Lezhës, sipas vlerësimit të aktorëve lokalë problematika kryesore janë **ndotja nga akuakultura** e vlerësuar me 3.5 pikë nga 4, e ndjekur nga **peshkimi i paligjshëm dhe gjuetia e paligjshme** të vlerësuar me 3.33 pikë nga 4.

REKOMANDIME

- Një pjesë e konsiderueshme e problemeve të identifikuara në këtë studim kërkojnë një funksionim më të mirë të sistemeve ekzistuese të monitorimit dhe kontrollit institucional dhe ndër-institucional në nivel lokal dhe qendror siç janë ndotja hidrokarbure, portuale, ujërat e balastës në porte.
- Ndërsa një pjesë e mirë e tyre kërkojnë investime konkrete, sidomos nga Bashkitë, siç mund të jenë impiante për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur urban, impiante për mbetjet urbane siç janë landfillet dhe incineratorët. Për të siguruar investime të qëndrueshme infrastrukturore, siç është Landfilli i Vlorës, apo impiante të trajtimit të ujërave të zeza është e rëndësishme dhe një program i detajuar kombëtar për rritjen e kapaciteteve vendore në lidhje me kontrollin, menaxhimin dhe inspektimin e mbetjeve në brezin bregdetar.
- Proceset e ristrukturimit, rishikimit dhe reformit në përgjithësi, të cilat kanë përfshirë shumë sektorë të mjedisit shpeshherë bëhen në mënyrë të nxituar dhe pa u konsultuar me evidencat shkencore dhe grupet e interesit. Në këtë mënyrë një proces gjithëpërfshirës konsultimi mes grupeve të interesit, shkencës dhe vendim-marrjes do të ishte i rekomanduar në proceset e planifikimit urban në bregdet dhe të rishikimit të rrjetit kombëtar të Zonave të Mbrojtura përgjatë bregdetit.
- Zonat bregdetare janë të destinuara të vuajnë presionin e madh njerëzor me flukse të shtuara, duke rritur popullimin sezonal deri në 2-3 herë më shumë sesa numri normal jashtë sezonit turistik. Ky fluks i shtuar rrit në mënyrë të shpejtë nevojat për menaxhimin e burimeve dhe mbetjeve. Në këto raste rekomandohet që të ndërtohet një sistem menaxhimi më efikas që do të adresonte problematikat e burimeve dhe mbetjeve duke u bazuar edhe në modele të aplikimit të taksave sezonale të dedikuara për bizneset.
- Problematika e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane kërkon një rikonceptim të të gjithë sistemit të menaxhimit duke aplikuar një qasje kapilare të menaxhimit nga njëra anë dhe duke rritur e forcuar kontrollin dhe monitorimin siç është modeli që ka dhënë efekte pozitive i aplikuar në Bashkinë e Lezhës. Megjithatë në mënyrë që modeli të jetë plotësisht efektiv ai duhet të shtrihet edhe në zonat rurale të Bashkive.
- Raporti evidenton se erozioni bregdetar është një fenomen i prekshëm, i cili kërcënon në mënyrë progresive plazhet dhe ekosistemet lagunore përgjatë bregdetit Adriatik. Marrja pa kriter e inreteve nga shtretërit e lumenjve rekomandohet që të ndalet dhe të vendoset nën një kontroll të rreptë mbikqëqyrjeje nga inspektoratet si edhe rekomandohet të ndërmerren programe të gjera ripyllëzimi në shpatet e pjerrët të luginave si edhe pranë bimësisë pionere të dunave bregdetare.
- Problemet mjedisore të identifikuara në këtë studim duhet të shërbejnë si një nxitje për autoritete por dhe organizatat e shoqërisë civile dhe programet e asistencës së huaj të nxisin një debat teknik më të gjerë për t'i konceptuar në projekte për adresim zgjidhjesh dhe të priorizohen në projekt buxhetet vendore vjetore dhe ato afat-mesme.

LITERATURA

- AKPT, 2015. Plani i integruar Sektorial për Bregdetin. [Në linjë]. Available at: www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/PINS_bregdeti [Qasja 16 July 2021].
- AKM. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2019. Tiranë. Aksesuar 12 korrik 2021; www.akm.gov.al
- Aleka Meliadou, Mak Kisevic, Roko Andrecevic, 2013. Adriatic sea environment program. Rapid assessment of pollution hotspots. Washington: World Bank.
- Ardian Hackaj, Manjola Duli, Enton Derraj, Bendis Bocari, Anis Kokomani, 2016. Strategjia Teritoriale e Bashkisë Durrës 2015 -2030, Durrës: Bashkia Durrës dhe CDDI.
- Abdulla Diku, Kristi Bashmili. Vlerësimi strategjik mjedisor Për hartimin e planit të detajuar të zonës së rëndësisë kombëtare Rana e Hedhun. Korrik 2020.
- AKZM. Pasaporta e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri. Tiranë, dhjetor 2019. Draft final
- AKZM. Studim për rivlerësimin e sistemit të rrjetit të zonave të mbrojtura mjedisore në Shqipëri (1990 - 2019), Tiranë, dhjetor 2019
- COM(2020) 660 final. Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Brussels, 6.10.2020
- Green27. ***The alternative view of environmental progress Albania's Negotiations with EU and Chapter 27***, Tirana, April 2021
- KKT, 2017. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, Vlorë: Bashkia Vlorë & Studio Konsulente DEASTUDIO & THYMIO PAPAYANNIS & ASSOCIATES INC.
- Nensi Lalaj. Vlerësimi i shkallës së ndotjes së mjedisit nga komponimet hidrokarbure në territorin e ish rafinerisë së naftës në Kuçovë dhe masat rehabilituese. (Disertacion), Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Tiranë 2021
- Report "Identification and Implementation of Adaptation Response Measures in the Drini - Mati River Deltas" (UNDP 2015).
- Word Data. Albania Gross Domestic per capita. Albania GDP per capita, 1980-2020 - knoema.com.
- Silvija Nora Kalnins. Identification and Implementation of the Adaptation Response Measures in the Drini-Mati River Deltas (PIMS 3629). UNDP, Tirana 2013.
- UNDP. Management of marine and coastline pollution for increased Safety at Sea and Ports in line with EU Maritime Law and Policy, Tirana, 2018.
- UNDP. Enabling transboundary cooperation and integrated water resources management in the extended Drin River Basin. Tirana, 2020. www.undp.org/albania.
- <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Ekspert?pagew2>.

SHTOJCA A

Pyetësi i për validimin e problematikave mjedisore

PYETËSOR MBI VLERËSIMIN E ÇËSHTJET MJEDISORE NË BREGDET

Informacion i përgjithshëm

WFD Shqipëri po zbaton paketën e iniciativës, “Pjesëmarrja e OShC-ve në vendimmarrje”. Bazuar në analizat e WFD, në Shqipëri, shoqëria civile është përfshirë kryesisht në fazën e zbatimit të politikave, por rrallë merr pjesë në caktimin e axhendës ose fazën e politikëbërjes. Situata është më e keqe në ekzekutivin (ministritë e linjës dhe Këshillin e Ministrave), pasi shpesh, ata miratojnë/adaptojnë legjislacion dhe rregullore pa u konsultuar paraprakisht me palët e interesit. OShC-të mjedisore kanë më pak akses tek vendimmarrësit sesa të tjerët pasi mjedisi nuk konsiderohet si një përparësi kryesore për zhvillimin e vendit. Sidoqoftë, ekziston një grup solid i OShC-ve i specializuar në çështjet mjedisore që ka kapacitet dhe përvojë, por përballët me pengesa të ndryshme për sa i përket ndikimit në politikëbërjen në nivelet lokale dhe qendrore.

Zhvillimi i rajoneve bregdetare në Shqipëri është bërë një përparësi për planet kombëtare të zhvillimit që shpesh drejtohen nga interesi dhe axhenda e sektorit privat. Shpesh, plane të tilla zhvillimore nuk këshillohen me aktorë të ndryshëm lokalë dhe nuk marrin parasysh shqetësimet mjedisore të ndikimit lokal ose kombëtar. Prandaj, ekziston një nevojë në rritje për një angazhim më proaktiv të OShC-ve dhe aktorëve të tjerë që të konsultohen dhe të ndikojnë tek vendimmarrësit duke marrë parasysh shqetësimet e ndryshme mjedisore të komuniteteve të tyre.

Në këtë kontekst, EcoAlbania-s i është mandatuar për përgatitjen e një raporti studimor për evidentimin e problematikave të qenësishme mjedisore në rajonet bregdetare duke siguruar dëshmi dhe të dhëna për çështjet mjedisore.

Seksioni 1: Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur

Shënim: Ju lutem plotësoni pyetësonin duke përzgjedhur alternativat sipas shpjegimit.

- 1 - Jo relevante, s'është problem
- 2 - Problem i vogël por është drejt zgjidhjes
- 3 - Është problem por jo shumë i madh
- 4 - Problem shumë i madh dhe evident

1. Sipas jush sa problematike është ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur në Qarkun tuaj?

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
1.1	Mungesa e një landfilli sanitar në bregdet bën që mbetjet të depozitohen në vendgrumbullime afër lumenjve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.1	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane jo effcent, mungesë e riciklimit të mbetjeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.1	Vendet e depozitimit të mbetjeve nuk plotësojnë standardet mjedisore dhe janë të vendosura në vende të papërshtatshme dhe të paplanifikuara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.1	Mungon ose nuk përfshin të gjithë hapësirën urbane, impianti i trajtimit të ujërave të përdorur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.1	Deltat lumore janë një emergjencë mjedisore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.1	Depozitimi i mbetjeve urbane në zona bregdetare pa kushte sanitare dhe mjedisore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.1	Shkarkime industriale të industrisë së peshkimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.1	Vendet e depozitimit të mbetjeve nuk plotësojnë standardet mjedisore dhe janë të vendosura në vende të papërshtatshme dhe të paplanifikuara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.1	Mungon ose nuk përfshin të gjithë hapësirën urbane, impianti i trajtimit të ujërave të përdorur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.1	Deltat lumore janë një emergjencë mjedisore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.1	Depozitimi i mbetjeve urbane në zona bregdetare pa kushte sanitare dhe mjedisore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.1	Shkarkime industriale të industrisë së peshkimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 2: Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike

2. Sipas jush sa problematike është erozioni detar dhe ndryshimet klimatike në Qarkun tuaj?

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
2.1	Mungesë të ndërtimit të rrjeteve të përshtatshëm të kanalizimit në bujqësi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.2	Shaktërimi i mbulesës bimore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.3	Përdorimi i shtratit të lumenjve si burim i shfrytëzimit të paligjshëm për materiale ndërtim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.4	Ndërhyrjet inxhinierike në shtretërit e lumenjve si diga, argjinatura etj. që pengojnë transportin e aluvioneve drejt bregdetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.5	Ndryshimet klimatike si pasojë e ngrohjes globale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 3: Ndotja detare dhe portuale

3. Sipas jush sa problematike është ndotja detare dhe portuale në Qarkun tuaj?

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
3.1	Ndotja nga hidrokarburet	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.2	Aktiviteti operacional në porte	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.3	Transferimi i ndotjes nga kontinenti (derdhja e ujërave të përdorur të patrajtuar)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 4: Shkatërrimi i biodiversitetit

4. Sipas jush sa problematike është shkatërrimi i biodiversitetit në zonën bregdetare të Qarkut tuaj?

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
4.1	Gjueti e paligjshme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.1	Mbipeshkimi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.3	Peshkimi i paligjshëm	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.4	Fragmentimi dhe tjetërsimi i habitateve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.5	Ndotja nga akuakultura	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.6	Përdorimi i mjeteve të gabuara për gjueti (lëndë plasëse, elektricitet; lëndë helmuese)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 5: Konfliktet e zhvillimit bregdetar

5. Sipas jush sa problematike janë nga pikëpamja mjedisore konfliktet e zhvillimit bregdetar në Qarkun

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
5.1	Zhvillimi urban / zgjerimi i zonave urbane të keq-planifikuara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.2	Zhvillimi i projekteve infrastrukturore (Autostrada, aeroporte etj.)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.3	Zhvillimi i projekteve me ndikim të qenësishëm në mjedis (Resorte turistike, hoteleri etj.)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 6: Prioritetet sipas kategorive (Clusters)

Shënim: Ju lutem plotësoni pyetësonin duke përzgjedhur alternativat sipas shpjegimit.

Proriteti 1: Situata është kritike dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme

Proriteti 2: Duhet të planifikohet ndërhyrje

Proriteti 3: Situata është e qëndrueshme por duhet të planifikohet ndërhyrje për përmirësim

Ju lutem përcaktoni çështjet më prioritare sipas jush që konsistojnë në problematika mjedisore në zonën bregdetare të Qarkut tuaj!

	Nën-çështjet	Vlerësimet			
		1	2	3	4
1	Ndotja nga mbetjet urbane dhe ujërat e ndotur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	Erozioni detar dhe ndryshimet klimatike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	Ndotja detare dhe portuale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4	Shkatërrimi i biodiversitetit të rivierës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5	Konfliktet e zhvillimit bregdetar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



Hartëzimi i problematikës mjedisore përgjatë bregdetit në Shqipëri

Rast Studimor: Qarku Vlorë, Durrës dhe Lezhë

